Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

gjyqesori-rks.org

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

Raporti i punës për vitin 2021

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Prill, 2022

© Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

LISTA E SHKURTESAVE

KGJK	.....	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
SKGJK	.....	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NJIGJ	.....	Njësia e Inspektimit Gjyqësor
GJS	.....	Gjykata Supreme
DHPGJS	.....	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
GJA	.....	Gjykata e Apelit
GJ.TH	.....	Gjykata Themelore
DAP	.....	Departamenti i Administratës së Përgjithshme
TIK	.....	Teknologji Informative dhe Komunikim
KE	.....	Komisioni Evropian
MD	.....	Ministria e Drejtësisë
OSHP	.....	Organi Shqyrtues i Prokurimit

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË 8

Përmbledhje ekzekutive 8

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN 9

1.1 Vizioni 9

1.2 Misioni 9

1.3 Mandati 10

1.4 Përbërja e Këshillit 11

PJESA E DYTË 12

2. AKTIVITETET E KËSHILLIT 12

2.1 Zgjedhja e Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit 13

2.2 Takimet dhe vendimet e KGJK 13

2.3 Emërimi i kryetareve të gjykatave dhe gjyqtareve mbikëqyrës 13

2.4 Avancimi i gjyqtarëve 14

2.5 Rekrutimi i gjyqtarëve 14

2.6 Vlerësimi i gjyqtarëve 14

2.7 Miratimi i akteve nënligjore 14

2.8 Transferimi i gjyqtarëve 14

2.9 Procedura Disiplinore e Gjyqtarëve 14

3. TË ARRITURAT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS GJATË VITIT 2021 17

3.1 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 20

3.1.1 Takimet me partnerë ndërkombëtarë 20

3.1.2 Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca, forume dhe tryeza 20

PJESA E TRETË 23

4. KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS 23

4.1 Komisioni për Çështje Normative 24

4.2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve 25

4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave 29

4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel 30

4.5 Komisioni për Trajnime 31
4.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye 32
5. BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR 33
5.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore 33
5.2 Ndryshimet buxhetore janar - dhjetor 2021 33
5.3 Buxheti dhe shpenzimet 2021 34
5.4 Të hyrat gjyqësore 38
6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS 41
7. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I KËSHILLIT 43
PJESA E KATËRT 44
8. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT 44
8.1 Zyra e Drejtorit 45
8.1.1 Departamenti i Administratës së Përgjithshme 46
8.1.2 Departamenti Ligjor 48
8.1.3 Departamenti për Buxhet dhe Financa 49
8.1.4 Departamenti i Statistikës 51
8.1.5 Departamenti i Logjistikës 52
8.1.6 Departamenti i Auditimit të Brendshëm 55
8.1.7 Zyra për Teknologji Informative dhe Komunikim 56
8.1.8 Zyra e Prokurimit 59
8.1.9 Zyra për Evidencë Penale 61
8.1.10 Integrimi Evropian 64
8.1.11 Zyra për Mbështetje dhe Përkthime 64
8.1.12 Komunikimi me Publikun 66
8.1.13 Certifikuesi 68
8.1.14 Arkiva 68
PJESA E PESTË 70
9. PANELI PËR LIRIMI ME KUSHT 70
10. NJËSIA E INSPEKTIMIT GJYQËSOR 72
11. NJËSIA PËR MBËSHTETJEN E KOMISIONEVE PËR REKRUTIM, AVANCIM DHE DISIPLINIM 75
12. SFIDAT 70

PJESA E PARË

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Punës për vitin 2021 paraqet dokumentin bazë për aktivitetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), si organ i pavarur kushtetues me qëllim të sigurimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional, llogaridhënës, transparent dhe të paanshëm.

Ky raport prezanton aktivitetet e Këshillit nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2021, në të cilin përfshihet veprimtaria, të arriturat dhe sfidat me të cilat është përballur Këshilli, gjatë kësaj periudhe.

Në pjesën hyrëse, raporti përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2021, duke filluar nga vizioni, misioni, kompetencat dhe baza ligjore e funksionimit të Këshillit, ndërsa në pjesën e dytë, informata të përgjithshme mbi KGJK, aktivitetet e Këshillit, si: Komisionet, takimet, avancimi i gjyqtarëve, aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore, rregulloret, udhëzimet administrative, vendimet, si dhe komisionet ad hoc.

Raporti mbulon edhe aktivitetet e gjykatave dhe Sekretariatit të KGJK-së, dhe atë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, Departamentit Ligjor, buxhetit dhe financave, performancës dhe statistikës, logjistikës, auditimit të brendshëm, integrimit evropian, teknologjisë informative dhe komunikimit publik, Projektit TIK/SMIL, evidencës penale, prokurimit, gjithashtu ky raport përfshin edhe punën e Panelit për Lirim me Kusht, Njësisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor. Kujdes i veçantë i është kushtuar të arriturave të Këshillit si dhe përmbushjes së obligimeve të dala nga raportet vlerësuese të vendit dhe atyre ndërkombëtare.

Në vijimësi, raporti përmban edhe të dhëna me rëndësi për buxhetin e sistemit gjyqësor, me fokus në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale si dhe investimeve kapitale.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës, KGJK ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me institucione dhe organizata joqeveritare në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të cilat janë bërë publike. Ndërsa, në fund të raportit janë paraqitur sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjatë vitit 2021.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mandatin e tij e ushtron në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe akteve përkatëse nënligjore. Ndërsa, me Ligjin për Gjykatat është e rregulluar organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Republikën e Kosovës.

1.1 Vizioni

Vizioni i Këshillit është një sistem gjyqësor që është i pavarur, i qasshëm për të gjithë, i drejtë dhe efikas në punën e tij, që jep llogari në punën e vet, që është funksional dhe që u përmbahet standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, kompetencës, profesionalizmit dhe transparencës.

1.2 Misioni

Misioni i Këshillit është të krijohet dhe të ruhet një sistem gjyqësor i pavarur, që iu ofron shërbime gjyqësore të paanshme për të gjithë pa dallim dhe që është funksional në të gjitha aspektet organizative dhe operative.

1.3 Mandati

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mandati i KGJK-së është si vijon:

- Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit;
- I propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;
- I propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, siguron se kandidati i propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse;
- Vendos për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit Gjykatës së Apelit, të kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- Siguron zbatim dhe mbikëqyrë kriteret për pranim në gjyqësor, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve;
- Vendos për shpalljen e konkurseve për kandidatët për pozita në gjyqësor;
- Vendos për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kritereve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- Vendos për numrin e gjyqtarëve në secilin juridiksion;
- rekomandon themelimin e gjykatave të reja dhe degëve të gjykatave, në pajtim me Ligjin për Gjykatat;
- Bën inspektimin gjyqësor;
- Administron gjyqësorin;
- Harton dhe mbikëqyrë buxhetin për gjyqësorin;
- Vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve;
- Vendos kriteret për vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve;
- Vendos për ngarkesën me lëndë të gjykatave;

- Siguron funksionimin efikas të gjykatave;
- Vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë;
- Miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe Kodin e Etikës për stafin administrativ gjyqësor, shkelja e të cilit është bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga funksioni;
- Vendos për miratimin e skemës unike të taksave gjyqësore të zbatueshme në mbarë territorin e Republikës së Kosovës;
- Siguron menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Miraton raportin vjetor mbi veprimtaritë e gjykatave dhe shpenzimet e buxhetit për gjyqësorin;
- Bashkëpunon me këshillat gjyqësore të shteteve të tjera dhe organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, me kusht që të mos ndikojë në pavarësinë e punës së tij;
- Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

1.4 Përbërja e Këshillit

KGJK sipas legjislacionit në fuqi, në përbërjen e tij ka trembëdhjetë (13) anëtarë: shtatë (7) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga gjyqësori, ndërsa gjashtë (6) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i anëtarëve të Këshillit është pesë (5) vjeçar. Në fund të vitit 2021, Këshilli në përbërjen e vet kishte dhjetë (10) anëtarë, që nënkupton se, tri (3) pozita nuk janë plotësuar akoma nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

PJESA E DYTË

2. AKTIVITETET E KËSHILLIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkundër faktit që edhe gjatë vitit 2021, u ballafaqua me sfida të shumta ku përfshihet edhe pandemia COVID-19, arriti që me sukses të përmbushte mandatin e vet kushtetues dhe ligjor. Masat e marra nga Qeveria dhe kryerja e punëve në periudha të caktuara vetëm me staf esencial kanë penguar rrjedhën normale të punës së gjyqësorit lidhur me ofrimin e shërbimeve të rregullta dhe krahas kësaj gjendje, në këto periudha janë trajtuar vetëm rastet e natyrës urgjente.

Këshilli, me qëllim të realizimit të mandatit të tij si dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjyqësorit në përgjithësi, ka ndërmarrë aktivitetet e nevojshme të cilat u fokusuan në:

- Përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve;
- Përmirësimin e transparencës së gjyqësorit dhe informimi i opinionit publik lidhur me aktivitetet e gjyqësorit;
- Forcimin në vazhdimësi të mekanizmave llogaridhënës, si atë të disiplinës dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve;
- Avancimin e gjyqtarëve;
- Rekrutimin e gjyqtarëve të rinj dhe
- Rekrutimi i bashkëpunëtoreve profesional.

KGJK gjatë kësaj periudhe, ishte pjesë e proceseve të rëndësishme të iniciuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e të cilat prekin fushën e funksionimit të gjyqësorit në vend. Për këtë qëllim, KGJK është përfshirë intensivisht në dhënien e komenteve lidhur me Draft Koncept Dokumentin për Zhvillimin e Procesit të Vettingut në Sistemin e Drejtësisë, si dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Sundim të Ligjit, i cili ka dalë si rezultat i Rishikimit Funksional.

Më qëllim të përmirësimit dhe shtimit të efikasitetit në fushën e gjyqësorit, Këshilli inicioj edhe një sërë aktivitetesh me rëndësi esenciale për funksionimin e pushtetit gjyqësor në përgjithësi, ku përfshihen:

- Themelimi i Komisionit për hartimin e raportit fakt mbledhës rreth funksionimit të administratës gjyqësore;
- Themelimi i Komisionit ad-hoc për auditimin e të dhënave statistikore;
- Themelimi i Komisionit për auditimin e ekzekutimeve të dënimeve gjyqësore në lëmin penale (dënimet me gjobë dhe burgim) dhe në lëmin kundërvajtëse;
- Hartimi dhe dërgimi i Planit të Veprimit për raportim në baza tre (3) mujore të administratorët e gjykatave, bazuar në të gjeturat e raportit fakt mbledhës;
- Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të masave anti COVID-19 në objektet e gjykatave.

2.1 Zgjedhja e Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit

Gjatë vitit 2021, Këshilli ka zgjedhur Kryesuesin e ri të KGJK-së, Albert Zogaj - gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që ish kryesuesit të KGJK-së, Skender Çoçaj, i kishte përfunduar mandati. Gjithashtu, gjatë këtij viti, KGJK, zgjodhi Qerim Ademaj, zëvendës kryesues të KGjK-së. Anëtarë të ri të KGJK-së, gjatë vitit 2021 u zgjodhën: Albert Zogaj dhe Teuta Ibrahimi, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, Drita Rexhaj, anëtare nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, si dhe Arjeta Sadiku dhe Fidan Hoxha nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave themelore.

2.2 Takimet dhe vendimet e KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit 2021, ka mbajtur njëzet e nëntë (29) takime, përfshirë këtu takimet e jashtëzakonshme dhe takimet e mbajtura në formë elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli ka nxjerrë gjithsejtë katërqind e tridhjetë e një (431) vendime.

2.3 Emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës

Po ashtu, KGJK ka emëruar kryetarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës Themelore Ferizaj dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Gjatë kësaj periudhe, ka emëruar Gjyqtarin Mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si dhe gjyqtarët mbikëqyrës të gjykatave përkatës në degët si: Graçanicë, Lipjan, Podujevë, Gllogoc, Viti, Shtërpcë, Kaçanik, Malishevë, Rahovec, Klinë, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Vushtrri dhe Skenderaj.

2.4 Avancimi i gjyqtarëve

Këshilli, ka avancuar dy (2) gjyqtarë duke i plotësuar pozitat vakante në Gjykatën e Apelit divizioni në Mitrovicë.

2.5 Rekrutimi i gjyqtarëve

KGJK ka përzgjedhur dhe caktuar gjashtë (6) gjyqtarë në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë. KGJK, gjithashtu ka përfunduar procesin e riemërimit të tridhjetë e shtatë (37) gjyqtarëve dhe i ka propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës për riemërim.

2.6 Vlerësimi i gjyqtarëve

Këshilli ka përfunduar vlerësimin e performancës së njëqind e dyzet e një (141) gjyqtarëve.

2.7 Miratimi i akteve nënligjore

Gjatë vitit 2021, Këshilli ka miratuar gjashtë (6) rregullore, një (1) rregullore për plotësim - ndryshim të rregullores dhe (2) Organogramet për Strukturën Organizative të Këshillit, tri (3) udhëzime si dhe një (1) udhëzues.

2.8 Transferimi i gjyqtarëve

Këshilli gjatë vitit 2021, ka transferuar përkohësisht katër (4) gjyqtarë.

2.9 Procedura Disiplinore e Gjyqtarëve

Në përputhje me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK ka pranuar njëqind e njëzet e një (121) ankesa disiplinore të ushtruara nga personat fizik dhe juridik ndaj gjyqtarëve, ankesa këto të trajtuara nga autoritetet kompetente dhe Këshilli. Nga këto ankesa, Këshilli ka pranuar njëqind e gjashtë (106) vendime nga autoritetet kompetente me të cilat ankesat janë refuzuar si të pa bazuara, prej tyre tetë (8) vendime për refuzim kanë qenë në lidhje me ankesat e pranuara në fund të vitit 2020, si dhe nëntëdhjetë e tetë (98) vendime për refuzimin e ankesave të vitit 2021.

Nga numri total i ankesave, për vitin 2021, KGJK ka pranuar nga autoritetet kompetente, njëmbëdhjetë (11) kërkesa për inicim të hetimit disiplinor, ndërsa dymbëdhjetë (12) ankesa nga totali i ankesave të pranuara dhe cekura më lartë janë bartur për shqyrtim dhe vendosje në vitin 2022. Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave për inicim të hetimeve disiplinore, KGJK ka themeluar njëmbëdhjetë (11) Panele Hetimore.

Në këtë drejtim, nga njëmbëdhjetë (11) panele hetimore të themeluara, KGJK ka pranuar tetë (8) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe tetë (8) raporte tjera mbi faktet dhe provat e mbledhura nga panelet hetimore të cilat janë themeluar në fund të vitit 2020.

Këshilli, gjatë kësaj periudhe bazuar në Ligjin Nr.08/L-003 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas detyrës zyrtare e ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen e suspendimit të një (1) gjyqtari në një rast disiplinor dhe me shumicë votash ka vendosur për suspendimin, deri në një vendim tjetër të Këshillit.

KGJK, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tetëmbëdhjetë (18) seanca dëgjimore dhe ka shqyrtuar gjashtëmbëdhjetë (16) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura.

Në seancat e cekura më lartë, pas shqyrtimit të raporteve, janë marrë gjithsejtë gjashtëmbëdhjetë (16) vendime dhe janë shqiptuar këto masa, si në vijim:

- Vërejtje jo publike me shkrim, tri (3) vendime;
- Vërejtje publike me shkrim, katër (4) vendime;
- Nuk është përgjegjës, gjashtë (6) vendime;
- Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej 30% për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj, një (1) vendim;
- Pushohet procedura disiplinore për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore, për njërin subjekt të hetimit, ndërsa për subjektin tjetër pretendimi i supozuar ndaj tij nuk përbënë shkelje disiplinore, një (1) vendim;
- Transferim i përhershëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, një (1) vendim.

Vlen të theksohet që nga masat e shqiptuara me lartë, pjesë e një raporti kanë qenë dy subjekte hetimi të ndryshëm, për të cilët janë shqiptuar masa të ndryshme, përkatësisht njëri me vërejtje publike me shkrim, ndërsa tjetri me zvogëlim të përkohshëm të pagës prej 30% për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj.

Në një raport tjetër të panelit hetimor në të cilën kanë qenë të përfshirë dy (2) subjekte hetimi, për të cilat KGJK ka vendosur që për njërin subjekt të pushohet procedura disiplinore për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore, për njërin subjekt të hetimit, ndërsa për subjektin tjetër ka vendosur se pretendimi i supozuar ndaj tij, nuk përbënë shkelje disiplinore.

Prandaj, numri i masave të shqiptuara nuk përputhet me numrin e raporteve të shqyrtuara dhe të cekura më lartë, për shkak se në dy (2) raporte hetimore i kemi katër (4) subjekte që KGJK ka shqiptuar katër (4) masa të ndryshme disiplinore.

Ndaj vendimit më të cilën është shqiptuar sanksioni disiplinor zvogëlimin e përkohshëm të pagës prej 30% për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj, është ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Kjo ankesë pas shqyrtimit në Gjykatën Supreme është miratuar pjesërisht si e themeltë dhe është ndryshuar vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që ka të bëjë me shqiptimin e sanksionit disiplinor, zvogëlimin e përkohshëm të pagës prej 30% për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj, ashtu që ankuesit i shqiptohet sanksioni disiplinor, Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej 30% për periudhën kohore prej katër (4) muaj.

Ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme është ushtruar edhe ndaj vendimit për Transferim i përhershëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm.

Tri (3) panele hetimore janë ende në fazë të hetimeve disiplinore, dhe kur KGJK do të pranoj raportet mbi faktet dhe provat e mbledhura, do të caktoj seancat dëgjimore.

3. TË ARRITURAT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS GJATË VITIT 2021

Transparenca e gjyqësorit dhe qasja e publikut në punën e gjyqësorit është mekanizmi më i mirë i kontrollit dhe paraqet një nga të arriturat të punës së gjyqësorit. Me qëllim të shtimit të transparencës, KGJK të gjitha takimet i ka transmetuar drejtpërdrejtë, përveç pikave të agjendës të cilat janë mbajtur të mbyllura për shkak se, sipas ligjit konsiderohen konfidenciale.

Gjithashtu, në kuadër të transparencës, KGJK ka vazhduar aktivitetet tjera duke i transmetuar drejtpërsëdrejt edhe takimet e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Publikimi i të gjitha vendimeve të gjyqësorit, po ashtu është e arritur e jashtëzakonshme e sistemit gjyqësor, e cila e rendit vendin tonë ndër të parat në regjion, sa i përket publikimit të vendimeve gjyqësore.

Gjatë këtij viti, KGJK hartoj Planin Strategjik 2022-2024 për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Qëllimi i këtij plani është zvogëlimi i numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në gjykata, si dhe sigurimi i përfundimit të një çështje sipas standardeve ndërkombëtare. Hartimit të Planit Strategjik 2022-2024 i ka paraprirë një procesi gjithëpërfshirës të komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë mes akterëve kryesor, si nga gjyqësori, ashtu edhe nga partneret ndërkombëtar dhe vendor, si dhe shoqëria civile.

Në këtë plan janë përcaktuar objektivat dhe veprimet, që gjyqësori së bashku me të gjitha trupat e saja do t'i ndërmarrin veprimet e duhura për të përmirësuar efikasitetin në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Plani bazohet në tri (3) shtylla kyçe:

- ✓ Rritja e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve;
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit në përballje me korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe
- ✓ Sigurimi i vendimeve të drejta të gjykatave.

Pas miratimit të Planit Strategjik, Këshilli dhe të gjitha gjykatat hartuan planet vjetore të veprimit, duke definuar në detaje aktivitetet e nevojshme për realizmin e objektivave të parapara në Strategji.

Gjykatat themelore treguan performancë të mirë duke zgjidhur më shumë lëndë në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Në grafikun e mëposhtëm, mund të shihni efikasitetin dhe mesataren e zgjidhjes së lëndëve për muaj, krahasuar me vitin paraprak.



U shënua progres i rëndësishëm në përmirësimin dhe ngritjen e transparencës së punës së gjyqësorit. Me ndihmën e programit të USAID-it, u ristrukturua faqja e internetit. Është me rëndësi të ceket se, gjykatat publikuan më tepër se 24,000 aktgjykime duke e avancuar transparencën e gjyqësorit ndaj publikut.

Këshilli, lansoi aplikacione të ndryshme për të përmirësuar qasjen në drejtësi përfshirë, mundësinë për vlerësimin e shërbimeve të gjykatës, kalkulimin e taksave gjyqësore dhe mundësinë për kalkulimin e sanksioneve penale. Aplikacione këto të mbështetura nga USAID dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë.

Gjithashtu, KGJK lansoi pasqyrën e performancës përmes së cilës qytetarët mund të mësojnë më tepër lidhur me performancën e gjyqësorit, përfshirë performancën individuale të gjyqtarëve. Kjo pasqyrë, ka rritur qasjen në të dhëna që kanë rëndësi thelbësore për shoqërinë civile gjatë monitorimit nga ana e saj të sistemit të gjyqësorit.

3.1 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjatë vitit 2021, në bazë të kompetencave ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, ka zhvilluar vizita, takime dhe ka marr pjesë në konferenca, forume, vizita studimore dhe tryeza të ndryshme.

3.1.1 Takimet me partnerë ndërkombëtarë

Kryesuesi ka zhvilluar takime me Ambasadën e SHBA-së, Ambasadën e Britanisë së Madhe dhe Ambasadën e Holandës, në Kosovë, të cilat janë zhvilluar në suaza të bashkëpunimit dhe mbështetjes që këto shtete japin për sistemin gjyqësor në Kosovë. Në kuadër të takimeve me partnerë ndërkombëtar ka zhvilluar takime tjera, si me: EULEX-in, Komisionin e Venecias, Zyrën e BE-së në Prishtinë, Këshillin e Evropës, USAID, OSBE, UNDP, si dhe përfaqësues të projekteve vendore dhe ndërkombëtare, si: EUKOJUST, NCCR dhe SMIL.

3.1.2 Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca, forume dhe tryeza

Gjatë periudhës 1 janar 2021 - 4 korrik 2021, ish Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, ka marr pjesë në konferenca, forume dhe tryeza pune, disa prej tyre si në vijim:

- Konferenca Vjetore e Prokurorëve;
- Takim me projektin e USAID - Chemonics;
- Ceremoninë e projektit të Zyrës së BE-së “Bashkimi Evropian/Programi i Sektorit të Drejtësisë për Kosovën”;
- Takim me dekanin e Fakultetit Juridik;
- Takime me drejtorin e Akademisë së Drejtësisë;
- Takime me Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Takime me Odën e Avokatëve të Kosovës;
- Takime me Ministrinë e Drejtësisë;
- Takime me përfaqësues të EULEX;
- Konferencën Bringin European Court of Human Rights Closer to Right Holders;
- Takime me përfaqësues të OSCE;
- Takim në Këshillin Ministror për Integrimin Evropian;

- Takim me krye shefin Ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Ceremoninë e INL/Ambasadës së SHBA-së për përfundimin e punimeve në arkivat e Pallatit të Drejtësisë (të lutem verifikoje titullin në komunikatë të KGJK-së);
- Takime me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së;
- Takim virtual me përfaqësuesit e projektit iProceeds-2/të Strasburg;
- Takim me Komitetin Drejtues të Programit Horizontal Facility II- projekt KoSEJ II
- Takim virtual me shtetet e Quintit, e organizuar nga Ambasada e SHBA-së, lidhur me procesin zgjedhor;
- Ceremoninë për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët e emëruar me mandat fillestar;
- Takim me përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së;
- Takim me Institucionin e Avokatit të Popullit;
- Takime me USAID dhe EUKOJUST;
- Takime me drejtorin e Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Takime me kryetar të gjykatave dhe
- Takim në Kuvendin e RKS-së, lidhur me procedurën rekrutuese të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

Me ardhjen në krye të KGJK-së nga korriku i vitit 2021, Kryesuesi i KGJK-së, Albert Zogaj, në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, ka marr pjesë në konferenca, forume dhe tryeza pune, si në vijim:

- Takime me kryetar të gjykatave, administratorë dhe ndihmës administratorë të gjykatave;
- Takime me gjyqtarë të gjykatave themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme;
- Pjesëmarrës në punëtori/tryeza lidhur me hartimin e draft/akteve normative të KGJK-së;
- Vizitë studimore në Strasburg organizuar nga Këshilli i Evropës, lidhur me “Forcimi i institucioneve në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimeve të tjera degraduese”;
- Takime me Kryetarin e KQZ-së;
- Takim me Drejtorin ekzekutiv dhe përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë;
- Takime me Drejtorin ekzekutiv të OAK;
- Takim me Drejtorin e Doganës së Kosovës;
- Takim me Avokatin e Popullit;

- Takim me Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese;
- Takime me Shefin e zyrës së EULEX, si dhe në tryezën për publikimin e Raportit të monitorimit nga EULEX-i;
- Takimet e Komitetit Drejtues të Programit të BE për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë;
- Takim me Ambasadoren e Holandës;
- Takim me Ambasadorin e OSCE;
- Takime me përfaqësues të Ambasadës së Britanisë;
- Pjesëmarrës në tryezën "Sfidat e sistemit gjyqësor në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Takime virtuale, si ligjërimi për Universitetin e Arkansas në Shkollën Juridike Little Rock Boen;
- Takime të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Takime me anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Takim me përfaqësues të shoqërisë civile;
- Takime me anëtarë dhe përfaqësues të KPK-së;
- Takime me grupin punues për Rishikim Funksional të Sektorit për Sundimin e Ligjit dhe
- Takime lidhur me Planin e veprimit për zbatimin e prioriteteve politike të BE- PV ERA II.

PJESA E TRETË

4. KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Këshilli realizon mandatin e vet përmes komisioneve të përhershme dhe atyre që themelohen për një mandat të caktuar ad-hoc.

Komisionet e përhershme

Të gjitha komisionet e përhershme të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit, kanë rregullat e tyre të punës dhe fushë veprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 16 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në kuadër të Këshillit funksionojnë këto Komisione të Përhershme, si në vijim:

- Komisioni për Çështje Normative;
- Komisioni për Vlerësimin e Performancës Gjyqësore;
- Komisioni për Administrimin e Gjykatave;
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe
- Komisioni për Trajnime.

Me qëllim të zbatimit të rregulloreve të brendshme, KGJK ka themeluar edhe:

- Komisionin për Emërimin e Gjyqtarëve;
- Komisionin për Kompensimin e Personave të Dënuar, ose të Arrestuar pa arsye.

Në vijim do të paraqesim punën e komisioneve gjatë vitit 2021:

4.1 Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative është Komision i përhershëm i Këshillit, përgjegjës për inicimin, përgatitjen dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe politikave të nevojshme për funksionimin e Këshillit dhe gjyqësorit. Komisioni përbëhet nga tre (3) gjyqtarë - anëtarë të Këshillit, duke përfshirë edhe një (1) anëtarë rezervë.

KÇN, në pajtueshmëri me Rregulloren mbi Organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndër të tjera është përgjegjës për inicimin, përgatitjen dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe politikave të nevojshme për funksionimin e Këshillit dhe gjyqësorit.

Bazuar në Planin e Punës dhe vendimeve që kanë dal nga takimet e Këshillit, Komisioni, gjatë vitit 2021 ka mbajtur tridhjetë e shtatë (37) takime, në të cilat kanë marrë pjesë edhe partnerët vendor dhe ndërkombëtarë, rrjedhimisht të gjitha draftet kanë konsumuar fazën e konsultimit publik.

KÇN, ka hartuar dhe rekomanduar për miratim në KGJK, gjashtë (6) rregullore dhe një (1) rregullore për plotësim/ndryshim të rregullores bazë, dy (2) Udhëzime Administrative dhe një (1) plotësim ndryshim të Udhëzimit Administrativ bazë dhe organogramin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor.

Rregulloret e miratuara gjatë këtij viti janë:

- Rregullore Nr.01/2021 për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve së bashku me Udhëzuesin dhe tri (3) shtojcat;
- Rregullore Nr. 02/2021 për Plotësim/Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2021 për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e gjyqtarëve dhe katërmbëdhjetë (14) shtojcat;
- Rregullore Nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional dhe tetë (8) shtojcat;
- Rregullore 05/2021 për Strukturën e Brendshme Organizative të Gjykatës Supreme dhe shtojcën – organongarmi i Gjykatës Supreme të Kosovës;

- Rregullore 06/2021 për Strukturën e Brendshme Organizative të Gjykatës së Apelit dhe shtojcën– organongarmin e Gjykatës së Apelit;
- Rregullore 07/2021 për Strukturën e Brendshme Organizative në gjykatat themelore dhe degët e tyre si dhe shtojcat – shtatë (7) organograme të Gjykatave Themelore me Degët e tyre.

KÇN, ka hartuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill edhe dy (2) Udhëzime Administrative dhe një (1) plotësim/ndryshim të Udhëzimit Administrativ bazë:

- Udhëzimi Administrativ Nr.01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të përpunuara;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2021 për Ruajtje, transferimin dhe asgjësimin e regjistrave dhe lëndëve gjyqësore dhe
- Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2021 për shfrytëzimin dhe përdorimin e automjeteve zyrtare në gjyqësorin e Kosovës.

Gjithashtu, KÇN ka hartuar:

- Organogramin për strukturën organizative të KGJK-së dhe
- Draft Rregulloren për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për etikë gjyqësore, draft i cili gjatë kësaj periudhe ka qenë në procedurën e konsultimit publik.

Komisioni ka hartuar Planin e Punës për vitin 2022, i cili ka prioritet hartimin dhe rekomandimin për miratim të një mori aktesh normative, të cilat do të lehtësojnë punën e KGJK-së dhe gjyqësorit në përgjithësi.

4.2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve është Komision i përhershëm Këshillit, i cili ka kompetencë të bëj vlerësimin e performancës e të gjithë gjyqtarëve.

Ky Komision përbëhet nga trembëdhjetë (13) gjyqtarë – anëtarë të rregullt, duke përfshirë edhe tre (3) gjyqtarë – anëtarë rezervë. Komisioni përbëhet nga gjyqtarë të të gjitha gjykatave, duke përfshirë pesë (5) gjyqtarë nga Gjykata Supreme, pesë (5) gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe tre (3) gjyqtarë nga gjykatat themelore. Anëtarët rezervë zgjedhën nga një (1) gjyqtar nga secila instancë gjyqësore.

Në përputhje me Ligjin për KGJK-në dhe Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve, Komisioni ka mbajtur nëntë (9) seanca plenare dhe ka përfunduar procesin e vlerësimit për:

Pesëdhjetë e nëntë (59) gjyqtarë për ngritje në detyrë, në këto pozita:

- Gjyqtarit mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
- Kryetarit të dy (2) gjykatave themelore;
- Gjyqtarit mbikëqyrës në dymbëdhjetë (12) degë të gjykatave themelore;
- Kryetarit të Gjykatës së Apelit;
- Gjyqtarëve në Gjykatën Supreme dhe
- Gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit.
- Tridhjetë e shtatë (37) gjyqtarë me mandat fillestarë me qëllim të ri-emërimit të tyre.
- Dyzet e pesë (45) gjyqtarë me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas metodës Random për periudhën e vlerësimit të viteve 2017, 2018 dhe 2019, nga të gjitha nivelet e gjykatave.



Prandaj, Komisioni ka përfunduar vlerësimin e njëqind e dyzet e një (141) gjyqtarëve sipas kategorive të paraqitura më sipër.

Bazuar në kornizën ligjore ka miratuar Planin vjetor të punës për vitin 2022, si tregues i përgjegjësive që ka Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, vlerësime këto që janë bazë për avancimin, apo uljen në detyrë si dhe për inicimin e procedurës për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit. Është dhënë në vlerësim të anëtarëve të Komisionit, lista e dyzet e katër (44) gjyqtarëve me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas metodës Random për vitin 2021, për periudhën e vlerësimit të viteve 2018, 2019 dhe 2020. Ky proces pritet të përfundojë në muajin mars të vitit 2022.

KGJK, ka themeluar Komisionet ad-hoc për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve si në vijim:

- Dy (2) anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, (pas përfundimit të mandatit);
- Një (1) kryetar i Gjykatës Themelore dhe
- Tetë (8) gjyqtarë mbikëqyrës të degëve të gjykatave themelore.

Proceset	Numri i gjyqtarëve të vlerësuar	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Ngritje në detyrë	59			7	36	16
Mandat fillestar	35			14	21	
Random 2020	45			4	33	8
Gjithsej	139	0	0	25	90	24


Shkallët e vlerësimit
Shkëlqyeshëm
17%
Mirë
18%
Shumë mirë
65%
Mirë
Shumë mirë
Shkëlqyeshëm

4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave

Komisioni për Administrimin e Gjykatave është Komision i përhershëm i Këshillit i cili përgatit dhe rekomandon politika për administrim të gjykatave.

Ky Komision ka mbajtur gjashtë (6) takime pune të rregullta dhe tre (3) takime konsultative, me ç'rast ka trajtuar me profesionalizëm dhe përkushtim nevojën e unifikimit të praktikës së administratës në të gjitha gjykatat e Kosovës.

KAGJ, në kuadër të kompetencave të veta ka nxjerrë dhe i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim:

- Memorandum shpjegues për krijimin e Komisioneve për vlerësimin dhe testimin e kandidatëve për interpretë dhe përkthyes gjyqësorë për çift gjuhësh:
    - Shqip - Serbisht dhe anasjelltas dhe
    - Serbisht-Anglisht dhe anasjelltas.
- Memorandum shpjegues për formimin e Grupit Punues për shqyrtimin dhe finalizimin e draft-Rregullores për caktimin e normës së punës së gjyqtarëve.
- Memorandum shpjegues për të:
    - Miratuar Formularin e plotësuar për Kompensimin e Avokatit Mbrojtës me shpenzime publike;
    - Autorizuar Komisionin për Çështje Normative që me përkrahjen e Departamentit për Buxhet dhe Financa të SKGJK-së dhe sekretares së KAGJ-it, të nxjerr Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (Nr.09/2014), për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike, sipas formularit të plotësuar;
    - Udhëzuar Departamentin për Buxhet dhe Financa i SKGJK-së, që në bashkëpunim me zyrtarët financiar të gjykatave, të organizoj trajnim për të gjitha sekretaret juridike të gjykatave, mbi mënyrën e aplikimit të Formularit për kompensimin e avokatit mbrojtës, e këtë pas miratimit nga KGJK, të Udhëzimit Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (Nr.09/2014), për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike.

- Memorandum shpjegues për Miratimin e:
  - Draft-Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Rregullores së Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB)Nr.05/2020, për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre, të cilat krijohen nga gjyqësori i Kosovës;
  - Listës së regjistrimit të lëndëve të Kundërvajtjes të cilat kanë plotësuar kushtet për asgjësim;
  - Memorandum shpjegues për themelimin e grupit punues për standardizimin e formave të vendimeve procedurale dhe
  - Memorandum shpjegues për Miratimin e Planit të Punës së Njësisë së Inspektimit Gjyqësor për vitin 2022.

Komisioni ka marrë pjesë në takimet e Grupit Punues për shqyrtimin dhe finalizimin e draft-Rregullores për caktimin e Normës së punës së gjyqtarëve, të formuar me Vendimin KGJK.nr.119/2021.

Në zbatim të Vendimit KGJK.nr.291/2021, datë 18 tetor 2021, ka filluar analizimin dhe rishqyrtimin në tërësi të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave.

4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni për Buxhet dhe Financa është Komision i përhershëm i Këshillit, i cili përgatit dhe rekomandon politikat për zhvillim, rishikim dhe menaxhim të buxhetit të Këshillit.

Në përputhje me Ligjin për KGJK dhe Rregulloren mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit, Komisioni, ka mbajtur disa takime dhe ka zhvilluar disa aktivitete që hynë në kuadër të mandatit dhe fushë veprimtarisë së komisionit.

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel në bashkëpunim me Komisionin për Administrimin e Gjykatave dhe në mbështetje të stafit të SKGJK-së, ka shqyrtuar organogramet në nivelin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor, përkitazi me numrin e gjyqtarëve dhe stafit tjetër administrativ mbështetës.

Komisioni ka shqyrtuar dhe finalizuar, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024. Në këtë dokument, janë paraparë të gjitha shpenzimet e planifikuara të KGJK-së, për periudhën afatmesme 2022-2024. Po ashtu, ky komision ka shqyrtuar dhe finalizuar kërkesën për Rishikim të Buxhetit 2021 për KGJK.

Komisioni ka shqyrtuar dhe finalizuar të gjitha kërkesat buxhetore të KGJK-së, për vitin 2022 duke përfshirë edhe kërkesat nga gjykatat.

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel, ka marrë pjesë në takimin e rregullt për dëgjimin e buxhetit të KGJK-së, i cili është mbajtur në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Në këtë takim, KGJK ka parashtruar kërkesat buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike, në veçanti kërkesat për pozitat shtesë të bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjor, etj.

4.5 Komisioni për Trajnime

Komisioni për Trajnime është Komision i përhershëm i Këshillit, i cili ushtron detyra dhe përgjegjësi bazuar në rregulloren për trajnimin e gjyqtarëve të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Në përputhje me Ligjin për KGJK dhe Rregulloren mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit, në fillim të vitit kalendarik, Komisioni ka miratuar Planin vjetor të punës për vitin 2021, dokument që ka reflektuar përgjegjësitë që ka Komisioni për Trajnime që burojnë nga korniza ligjore e zbatueshme për trajnimet e gjyqtarëve.

Komisioni ka nxjerrë dhe përpunuar të dhënat e vitit paraprak lidhur me vijueshmërinë e trajnimeve të gjyqtarëve dhe si rezultat i këtyre të dhënave dhe gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19, në vitin 2020, pas një analize i ka rekomanduar Këshillit që të shtyhet afati për përmbushjen e fondit të ditëve, deri me datë 30 qershor 2021. Në koordinim me Akademinë e Drejtësisë, të gjithë gjyqtarët janë njoftuar për obligimet e tyre të pa-përmbushura, ndërsa në muajin qershor 2021 është vlerësuar përmbushja e trajnimeve për vitin 2020, me ç'rast është konstatuar se fondi i ditëve i përcaktuar me rregullore është respektuar.

Komisioni ka monitoruar zbatimin e Rregullores për trajnimin e gjyqtarëve dhe ka bërë konsultime e nevojshme me kryetarët e gjykatave, si dhe me komisionet e tjera të Këshillit lidhur me rekomandimet eventuale, për tema të detyrueshme për trajnime për kategori gjyqtarësh, përfshirë edhe për gjyqtarë individualë.

Komisioni në koordinim me zëvendës kryesuesin e KGJK-së, ka përgatitur një raport duke analizuar gjendjen aktuale të trajnimeve të gjyqtarëve, përfshirë këtu analizën e trajnimit të kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve mbikëqyrës dhe stafit të administratës dhe ka paraqitur rekomandimet konkrete për secilën fushë të interesit, të cilat janë miratuar në KGJK.

4.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye

Në përputhje me Ligjin për KGJK dhe Rregulloren mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit, Komisioni për Kompensimin e Dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye, gjatë vitit 2021 ka shqyrtuar dhe kompensuar gjithsejtë: njëqind e dyzet e nëntë (149) raste në shumën prej, 457,501.28 €, për shkak të privimit të tyre pa bazë ligjore dhe pa arsye.

5. BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

5.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore

Buxheti fillestar i KGJK-së si organizatë buxhetore dhe njëmbëdhjetë (11) programet e tij: Sekretariati i KGJK, Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Gjilan, Gjykata Themelore në Ferizaj, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Themelore në Gjakovë dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë për vitin 2021, sipas Ligjit Nr.07/L-041 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës është gjithsejtë: 29,194,592.00 € (me të hyra, pa donacione), për gjithsejtë 2,177, pozita, prej tyre 452 gjyqtarë dhe 1,725 pozita administrative.

5.2 Ndryshimet buxhetore janar - dhjetor 2021

Në muajin gusht 2021 është bërë rishikimi i buxhetit me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-016, Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-041, Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Sipas këtij ligji, buxheti i KGJK-së ka ndryshuar vetëm në kategorinë e shpenzimeve kapitale për 100,000.00 € të cilat i janë ndarë Ministrisë së Punëve të Brendshme për realizimin e projektit "Përpunimi i fasadës strukturale me hapje në kompleksin e Pallatit të Drejtësisë".

Me këtë ndryshim sipas Ligjit Nr. 08/L-016, buxheti i KGJK-së është gjithsejtë: 29,094,592€ (me të hyra, pa donacione), për gjithsejtë: 2,177 pozita, prej tyre 452 gjyqtar dhe 1,725 pozita administrative. Pas rishikimit gjatë vitit, kryesisht në tremujorin e katërt kanë ndodhur ndryshime në buxhet sipas kërkesave nga KGJK dhe vendimeve të Qeverisë.

Buxheti final i KGJK-së, në fund të vitit fiskal 2021 me të hyra dhe donacione është **28,468,556.41 €**. **Pjesëmarrja e buxhetit përfundimtar të KGJK-së në buxhetin e Kosovës shprehur në përqindje është 1.13 %**.

KGJK, ka pasur donacione në shumën prej, 30,564.71 € nga UNDP dhe GIZ kryesisht për mbështetjen e stafit administrativ në disa gjykata të Kosovës (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore Prishtinë, Gjykata Themelore Mitrovicë dhe Sekretariati i KGJK-së.

5.3 Buxheti dhe shpenzimet 2021

Në tabelën nr.1 është paraqitur buxheti fillestar, buxheti final, buxheti i zotuar si dhe realizimi i buxhetit të Këshillit sipas kategorive ekonomike.

BUXHETI DHE SHPENZIMET E KGJK-së 2021						
Kategoritë ekonomike	**Buxheti fillestar 2021**	**Buxheti Final 2021**	**Buxheti i zotuar**	**Buxheti zotuar %**	**Buxheti i shpenzuar**	**Buxheti i shpenzuar %**
Paga dhe shtesa	24,166,766.00	23,260,722.93	23,256,312.93	99.98	23,256,312.93	99.98
Mallra dhe shërbime	3,407,826.00	3,557,185.75	3,554,778.82	99.93	3,491,931.34	98.17
Shpenzime komunale	350,000.00	330,733.05	330,147.07	99.82	328,194.54	99.23
Subvencione dhe transfere	500,000.00	756,350.00	457,501.28	60.49	457,501.28	60.49
Shpenzime kapitale	770,000.00	533,000.00	532,850.00	99.97	473,688.89	88.87
Donacione		30,564.71	20,860.64	68.25	20,860.64	68.25
Totali	**29,194,592.00**	**28,468,556.44**	28,152,450.74	**98.89**	28,028,489.62	**98.45**

Tabela 1. Buxheti dhe Shpenzimet e KGJK-së 2021

Sipas grafikonit në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit të Këshillit në përqindje (%) për secilën kategori ekonomike.



Siç shihet në tabelën nr.1 dhe në grafikonin e mësipërm, buxheti i përgjithshëm i KGJK-së, prej **28,468,556.44 €** në vitin 2021 është zotuar në shumën prej **28,152,450.74 €**, shprehur në përqindje **98.89 %,** ndërsa është shpenzuar **28,028,489.62 €**, shprehur në përqindje **98.45 %.**

Sipas kategorive ekonomike buxheti përgjithshëm i KGJK është zotuar dhe shpenzuar si në vijim:

- **Paga dhe Shtesa**: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 23,260,722.93 €, janë zotuar dhe shpenzuar 23,256,312.93 €, shprehur në përqindje 99.98 %;
- **Mallra dhe Shërbime**: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 3,557,185.75 €. janë zotuar 3,554,778.82 € shprehur në përqindje 99.93 %, ndërsa janë shpenzuar 3,491,931.34 €, shprehur në përqindje 98.17 %;
- **Shpenzimet Komunale**: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 330,733.05 €, janë zotuar 330,147.07 € shprehur në përqindje 99.82 %, ndërsa janë shpenzuar 328,194.54 €, shprehur në përqindje 99.23%;
- **Subvencione dhe transfere:** Nga shuma vjetore e buxhetit nga kjo kategori për transfere prej 756,350.00 €, janë zotuar dhe shpenzuar 457,501.28 €, shprehur në përqindje 60.49 %;
- **Shpenzimet Kapitale**: Nga shuma vjetore e buxhetit 533,000.00 €, janë zotuar 532,850.00 € shprehur në përqindje 99.97 %, ndërsa janë shpenzuar 473,688.89 €, shprehur në përqindje 88.87 %.

Në tabelën nr.2 është paraqitur buxheti fillestar, buxheti final, buxheti i zotuar si dhe realizimi i buxhetit të Këshillit sipas programeve buxhetore.

BUXHETI DHE SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE TË KGJK-SË 2021						
Kategoritë ekonomike	**Buxheti fillestar 2021**	**Buxheti final 2021**	**Buxheti i zotuar**	**Buxheti i zotuar %**	**Buxheti i shpenzuar**	**Buxheti i shpenzuar %**
Sekretariati i KGJK-së	26,793,577.00	26,081,599.24	25,775,496.62	**98.83**	25,664,999.57	**98.40**
NJIGJ	133,524.00	130,229.83	129,891.21	**99.74**	129,814.50	**99.68**
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	51,005.00	23,009.18	23,009.16	**100.00**	23,009.16	**100.00**
Gjykata e Apelit	48,144.00	31,411.82	31,411.82	**100.00**	31,411.82	**100.00**
Gjykata Themelore Prishtinë	629,675.00	667,238.46	660,374.46	**98.97**	650,522.03	**97.49**
Gjykata Themelore Prizren	261,200.00	279,153.26	278,809.03	**99.88**	277,694.02	**99.48**
Gjykata Themelore Gjilan	296,310.00	288,442.95	288,442.95	**100.00**	288,438.95	**100.00**
Gjykata Themelore Ferizaj	213,900.00	207,811.84	207,379.14	**99.79**	206,778.14	**99.50**
Gjykata Themelore Pejë	219,090.00	238,388.87	238,379.57	**100.00**	236,811.96	**99.34**
Gjykata Themelore Gjakovë	194,600.00	165,964.22	165,964.22	**100.00**	165,953.02	**99.99**
Gjykata Themelore Mitrovicë	353,567.00	355,306.77	353,292.56	**99.43**	353,056.45	**99.37**
Totali	**29,194,592.00**	**28,468,556.44**	**28,152,450.74**	**98.89**	28,028,489.62	**98.45**

Tabela 2. Buxheti dhe Shpenzimet sipas programeve buxhetore të KGJK-së 2021

Sipas grafikonit në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit në përqindje (%) për secilin program buxhetor të Këshillit.



Siç shihet në tabelën nr.2 dhe grafikonin e mësipërm, sipas programeve buxheti i Këshillit është shpenzuar si në vijim:

- **Buxheti për programin e Sekretariatit të KGJK:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.83 %, ndërsa është shpenzuar 98.40 %.
- **Buxheti për programin e Njësisë për Inspektimin Gjyqësor:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 99.74 %, ndërsa është shpenzuar 99.68 %.

- **Buxheti për programin e Gjykatës Supreme dhe Dhomës së Posaçme:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 100.00 %, ndërsa është shpenzuar 100.00 %.
- **Buxheti për programin e Gjykatës së Apelit Prishtinë:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 100.00 %, ndërsa është shpenzuar 100.00 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Prishtinë:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.97 %, ndërsa është shpenzuar 97.49 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Prizren:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 99.88 %, ndërsa është shpenzuar 99.48 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Gjilan:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 100.00%, ndërsa është shpenzuar 100.00% .
- **Buxheti për programin e Gj.Th Ferizaj:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 99.79%, ndërsa është shpenzuar 99.50 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Pejë:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 100.00 %, ndërsa është shpenzuar 99.34 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Gjakovë:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 100.00 %, ndërsa është shpenzuar 99.99 %.
- **Buxheti për programin e Gj.Th Mitrovicë:**
  Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 99.43 %, ndërsa është shpenzuar 99.37 %.

5.4 Të hyrat gjyqësore

Të hyrat gjyqësore të gjeneruara nga Këshilli, përkatësisht nga Gjykatat dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në vitin 2021 janë gjithsejtë: 9,019,138.70 €.

Realizimit i të hyrave gjyqësore është 129.60 % (29.60% rritje) në krahasim me planifikimin (parashikimin) vjetor fillestar për vitin 2021 ku parashikimi fillestar ka qenë 6,959,118.00 €.

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve bazuar në të dhënat historike dhe të hyrat jo tatimore të arkëtuara gjatë vitit, nga Niveli Qendror i ka ndryshuar projeksionet (parashikimet) e të hyrave për vitin 2021 dhe për periudhën trevjeçare 2022-2024. Me ndryshimin e këtyre projeksioneve për KGJK në vitin 2021, janë rishikuar të hyrat nga 6,959,118.00 € në 7,718,557.00€, prandaj bazuar në këtë parashikim, përqindja e realizuar (arkëtuar) është 116.85 % (16.85 % rritje) nga shuma e rishikuar vjetore prej 7,718,557.00 €.

Në krahasim me vitin e kaluar kemi rritje në arkëtimin e të hyrave në shumë prej 2,976,086.70 ose 49.25% (9,019,138.70 - 6,043,052.00 = 2,976,086.70).

Në tabelën nr.3 janë paraqitur të hyrat gjyqësore sipas llojit, shumës dhe pjesëmarrjes në përqindje.

TË HYRAT GJYQËSORE JANAR-DHJETOR 2021		
LLOJI I TË HYRAVE	**SHUMA SIPAS LLOJIT**	**PJESËMARRJA NË %**
Taksat e Gjykatës -50021	3,215,508.83	35.65
Gjobat e Trafikut -50101	736,275.58	8.16
Gjobat e Gjykatës -50102	4,838,741.63	53.65
Taksë për Kompensimin e Viktimave të Krimit - 50019	222,380.00	2.47
Të hyrat nga viti i kaluar-61000	2,256.06	0.03
Të hyrat nga konfiskimet -50111	3,976.60	0.04
TOTALI	**9,019,138.70**	**100%**

Tabela 3. Të hyrat gjyqësore Janar-Dhjetor 2021

Sipas grafikonit në vijim pasqyrohet pjesëmarrja e të hyrave gjyqësore në përqindje (%).



6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

Në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, Asambleja ka mbajtur tri (3) takime, nga të cilat janë nxjerr disa rekomandime. Këto takime janë mbajtur me pjesëmarrje të kombinuar fizike dhe përmes platformës online.

Këtë vit, është zgjedhur Kryesuesi i Asamblesë, Armend Berisha, Kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë, mirëpo i njëjti në muajin shtator, ka hequr dorë nga detyra e Kryesuesit të Asamblesë, me ç'rast anëtarët e Asamblesë zgjodhën Kryesuesin e ri të Asamblesë, Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Takimet e Asamblesë janë mbështetur nga Kryesuesi i KGJK-së, i cili ka shprehur gatishmërinë e Këshillit Gjyqësor, përkatësisht Zyrës së Kryesuesit për adresimin e të gjitha çështjeve dhe sfidave të gjyqësorit, me qëllim që rekomandimet që dalin nga Asambleja, të adresohen në KGJK. Nga muaji nëntor, në bazë të Vendimit të Këshillit Gjyqësor, KGJK.nr.297/2021, takimet e Asamblesë transmetohen drejtpërdrejtë në ueb faqen e KGJK-së dhe në rrjetin social Facebook.

Rekomandimet e Asamblesë janë lidhur me çështjet si në vijim:

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe efektet e saj afatgjata në praktikën e tanishme dhe të ardhshme ligjore;
- Përfshirja e të dhënave në sistem – të dhënat në aktgjykime;
- Revokimet e urdhër arresteve të lëshuara nga gjyqtarët;
- Procedura për lëshimin e letër – rreshtimeve ndërkombëtare në Interpol;
- Nevoja e hartimit të planit të punës për lëndët e vjetra;
- Kthimi i garancioneve - depozitat;
- Racionalizimi i shpenzimeve për shërbimet telefonike dhe veturave zyrtare;
- Kompletimi i dosjeve penale të cilat dorëzohen nga gjykatat themelore në Gjykatën e Apelit;
- Përdorimi i plotë dhe intensiv i Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL);
- Kompensimi i personave të dënuar ose arrestuar pa arsye;
- Kompensimi i komisioneve si dhe grupeve punuese të themeluara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Dorëzimi i ftesave nga shërbimi i gjykatave dhe
- Lejimi për fillimin e procesit të asgjësimit të regjistrave dhe lëndëve gjyqësore.

KGJK, komfor Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, me vendimin KGJK.nr.412/2021, ka caktuar anëtarët e Asamblesë nga radhët e gjyqtarëve mbikëqyrës të gjykatave themelore për vitin 2022.

Aktualisht në proces e sipër është plotësim/ndryshimi i Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, i cili propozim i dhënë nga Asambleja është shqyrtuar në Këshill dhe është vendosur që të autorizohet Komisioni për Çështje Normative, për ndërmarrjen e veprimeve për ndryshim/plotësim të Rregullores Nr. 07/2017, në bazë të propozimeve që do të parashtrohen nga Asambleja.

7. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I KËSHILLIT

KGJK, me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të ndryshme që lidhen me punën e gjyqësorit, ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi ndër-institucional me institucionet vendore në veçanti ishte me: Këshillin Prokurorial të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës, Policinë e Kosovës, universitetet e ndryshme, organizatat jo qeveritare, shoqëritë civile etj.

Bashkëpunimet më të rëndësishme me institucionet, donatorët dhe partnerët ndërkombëtar përfshijnë: Ambasadën Amerikane, Zyrën e BE-së në Prishtinë, USAID, UNDP, Qeverinë e Norvegjisë, EULEX, Këshillin e Evropës, etj.

KGJK, gjatë vitit 2021 ka nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi si në vijim:

- Memorandum mirëkuptimi në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Fakultetit Juridik – Universitetit të Prishtinës;
- Memorandum ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë;
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS);
- Marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim reciprok ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës;
- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Aktivitetin e qasjes së publikut në informacione gjyqësore;
- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe/ose Gjykata Supreme dhe Grupit Këshillëdhënës për Sundim të Ligjit, në zbatim të projektit "Mbështetje për themelimin e zyrës për rikuperimin e pasurive dhe krijimin e qendrës burimore";
- Memorandum bashkëpunimi në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Youth Initiative for Human Rights - Kosovo (YIHR - KS).

PJESA E KATËRT

8. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është organ administrativ profesional i themeluar me Ligj për KGJK-në, i cili në kuadër të tij ka strukturën e vet organizative me të cilën ofron mbështetje profesionale dhe administrative Këshillit dhe gjykatave. Ky organ, përbëhet nga nëpunësit civil dhe zyrtarët e angazhuar në bazë të marrëveshjeve të veçanta të cilët përbëjnë administratën qendrore të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Brenda strukturës se tij, Sekretariati ka këtë rregullim organizativ:

- Departamenti i Administratës së Përgjithshme;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Buxhet e Financa;
- Departamenti për Teknologji Informative dhe Komunikim;
- Departamenti i Auditimit të Brendshëm;
- Departamenti Logjistikës;
- Departamenti i Statistikës;
- Zyra e Prokurimit;
- Zyra për Përkthim dhe Mbështetje;
- Zyra për Evidencë Penale;
- Integrimi Evropian;
- Komunikimi me Publikun;
- Certifikuesi dhe
- Arkiva.

8.1 Zyra e Drejtorit

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit është Zyrtari Kryesor Administrativ. Drejtori i raporton Këshillit dhe Kryesuesit të Këshillit.

Sekretariati administron buxhetin e miratuar të gjyqësorit, menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të gjyqësorit, bazuar në ngarkesën me punë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, themelimin e sistemit të vlerësimit të performancës, sigurimin e disiplinimit të duhur të punonjësve të gjykatës si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit.

SKGJK siguron që gjykatat të kenë furnizim të duhur dhe me kohë me materialet e nevojshme për funksionimin efikas të gjykatave, si dhe ofron mbështetje administrative dhe profesionale për Këshillin dhe Komisionet e tij, gjithashtu ndërmerr detyra dhe autorizime të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit.

Ndër të tjera, në kuadër të përgjegjësive të tij, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerr katërqind e nëntë (409) vendime të ndryshme si dhe ka nënshkruar njëqind e shtatëmbëdhjetë (117) akt emërime dhe pesëdhjetë e nëntë (59) marrëveshje për shërbime të veçanta.

Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë më të detajuar aktivitetet e departamenteve dhe njësive të Sekretariatit.

8.1.1 Departamenti i Administratës së Përgjithshme

Janë realizuar aktivitet si në vijim:

Pozitat e aprovuara:
Me Ligjin mbi Buxhetin e vitit 2021, për vijën buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë lejuar gjithsejtë: dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë (2,177) pozita. Vlen të theksohet se, Buxheti i KGJK-së është rritur për gjashtëdhjetë e katër (64) pozita në vitin 2021.

Në kuadër të KGJK-së, kemi dy (2) programe buxhetore:

- Programi buxhetor i Sekretariatit i KGJK-së, 2,170 pozita: prej tyre 452 pozita për gjyqtar dhe 1718 pozita për të punësuar tjerë si dhe
- Programi buxhetor i Njësisë për Inspektim Gjyqësor - shtatë (7) pozita.

Planifikimi i personelit për vitin 2021:
KGJK, ka aprovuar Planin e Personelit për vitin 2021 për: SKGJK, NJIGJ, Gjykata dhe degët e tyre sipas rekomandimit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme.

Procedura të rekrutimit/ Punësime të reja:
Në gjyqësorin e Kosovës (SKGJK dhe gjykata) gjatë vitit 2021 kanë qenë të publikuara gjithsejtë: njëqind e gjashtëdhjetë e tetë (168) procedura rekrutimi prej të cilave:

- Konkurs publik i jashtëm: nëntëdhjetë e gjashtë (96) pozita:

  - Të realizuara: shtatëdhjetë e një (71);
  - Në procedurë ankimore: tetë (8) dhe
  - Në procedurë rekrutimi: shtatëmbëdhjetë (17).

- Konkurs i brendshëm/ avancim në detyrë: pesëdhjetë e dy (52) pozita:

  - Të realizuara: katër dhjetë e dy (42);
  - Në procedurë ankimore: zero (0) dhe
  - Në procedurë rekrutimi: dhjetë (10).

- Mënyrë tjetër/ mbështetje financiare e UNDP-së dhe Bashkëpunim projekti KGJK/ NCCR, tridhjetë e pesë (35) pozita:

- Të realizuara: pesëmbëdhjetë (15) – Konsulent të përkohshëm (KGJK/ NCCR);
- Të realizuara: tetë (8) - përkthyes (UNDP) dhe
- Të realizuara: dymbëdhjetë (12) – zyrtar ligjor (UNDP).

Përfundim i marrëdhënies së punës:
Në gjyqësorin e Kosovës kemi pasur gjithsejtë: tetëdhjetë e nëntë (89) përfundime të marrëdhënies së punës:

- Pensionim: gjashtëdhjetë e një (61);
- Dorëheqje: shtatëmbëdhjetë (17) dhe
- Vdekje: dymbëdhjetë (12).

Disiplinimi:
Në gjyqësorin e Kosovës i janë nënshtruar masave disiplinore gjithsej: njëmbëdhjetë (11) të punësuar dhe janë shqiptuar këto masa:

- Pezullim i marrëdhënies së punës: tre nëpunës (3);
- 1/3 e pagës për një muaj: tre nëpunës (3);
- Qortim verbal: një nëpunës (1);
- Lirim nga përgjegjësia: një nëpunës (1) dhe
- Në procedurë: tre nëpunës (3).

Ndryshimet organizative:
Gjatë tërë vitit, Departamenti ka qenë i angazhuar në ndryshimet organizative:

- Draft Rregullore për Strukturën e Brendshme Organizative të Gjykatës Supreme;
- Draft Rregullore për Strukturën e Brendshme Organizative të Gjykatës së Apelit;
- Draft Rregullore për Strukturën e Brendshme Organizative të Gjykatave Themelore dhe
- Draft Rregullore për Strukturën e Brendshme Organizative të KGJK-së dhe Sekretariatit;

Janë kryer me kohë të gjitha obligimet mbi pagat dhe shtesat në pagë, ka asistuar në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, Komisionin disiplinor dhe të gjitha detyrat dhe obligimet tjera ligjore që bien në kompetencë të departamentit.

8.1.2 Departamenti Ligjor

Janë hartuar këto akte nënligjore:

- Ofrimi i udhëzimeve dhe monitorimin e shërbimeve në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore për Këshillin dhe Komisionet e Këshillit;
- Hartimi i drafteve të rregulloreve të cilat janë dërguar në KÇN për procedurë të mëtutjeshme, të raporteve, opinioneve ligjore, vendimeve;
- Kontrolli i pajtueshmërisë së akteve nënligjore të Këshillit me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Ofrimi i këshillave dhe analizave ligjore për veprimtarinë e Këshillit dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Këshillit, gjykatave dhe nevojave të Sekretariatit;
- Hartimi i shkresave dhe akteve të ndryshme për nevojat e Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njësive të Sekretariatit, përfshirë kontrollin ligjor të tyre dhe
- Angazhimi dhe ndihma profesionale dhe administrative rreth çështjeve organizative të takimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të KGJK-së dhe komisioneve të tij.

Departamenti ka përfaqësuar KGJK-në në konteste të ndryshme gjyqësore dhe administrative në rreth një qind e nëntëdhjetë e tetë (198) përfaqësime në seancat gjyqësore në të gjitha departamentet, në të cilat Këshilli ka qenë në cilësinë e palës së paditur ose palë paditëse. Janë hartuar mbi shtatëdhjetë (70) përgjigje në padi, mbi njëzet e shtatë (27) ankesa të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë, revizione, prapësime ndaj urdhrave përmbarimore, padi etj.

Ka kryesuar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, gjatë vitit 2021 dhe ka hartuar shtatëdhjetë e katër (74) vendime lidhur me ankesat e palëve.

Janë hartuar katërqind e tridhjetë e një (431) vendime të nxjerra nga Këshilli. Ka pranuar përafërsisht dyqind e tetëdhjetë e pesë (285) shkresa-parashtresa nga qytetar, avokat, institucione dhe OJQ të ndryshme drejtuar Këshillit Gjyqësor, të cilët kanë pas të bëjnë kryesisht rreth çështjes së procedurave ligjore, pretendimeve për sjellje të pahijshme ndaj gjyqtareve dhe për të gjitha këta shkresa/parashtresa është dhënë përgjigje.

Janë hartuar memo të ndryshme si dhe tridhjetë e pesë (35) opinione ligjore. Është ofruar ndihmë profesionale edhe për komisionet Ad Hoc të themeluara nga KGJK lidhur me auditimin e ekzekutimit të dënimeve gjyqësore në lëmin penale dhe në lëmin e Kundërvajtjes.

Po ashtu, është dhënë ndihmë profesionale në inspektimin për komisionin Ad Hoc, i cili ka pasur për qëllim informimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19.

Departamenti ka qenë i angazhuar në kompletimin e lëndës sa i përket vlerësimit të performancës së kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, si dhe është në proces të auditimit statistikor të lëndëve për pesë (5) gjyqtarë të përzgjedhur që kanë qenë në procedurë të avancimit.

Ky departament, ka mbështetur profesionalisht të gjitha Komisionet e KGJK-së si dhe panelet hetimore.

8.1.3 Departamenti për Buxhet dhe Financa

Departamenti për Buxhet dhe Financa, fushë veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin vjetor të Buxhetit, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Gjykata, pastaj në Qarkoret Buxhetore, Rregulloret, Udhëzimet nga Departamenti i Thesarit dhe i Buxhetit në Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe në Rregulloret, Udhëzimet dhe Vendimet e brendshme të KGJK/SKGJK-së, ka arritur të realizoj dhe përfundoj këto aktivitete si në vijim:

- Ekzekutimi i buxhetit të KGJK-së sipas ndarjeve buxhetore në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 Nr.07/L-041, Rishikimit të buxhetit sipas ligjit Nr. 08/L-016, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-041, Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 si dhe sipas ndryshimeve buxhetore të ndodhura gjatë vitit;

- Në bashkëpunim me njësitë tjera të SKGJK-së, është bërë përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024, sipas instruksionit për përgatitjen e KASH-it nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila pas analizimit dhe shqyrtimit nga Komisioni për buxhet, financa dhe personel i KGJK-së;
- Planifikimi i buxhetit 2022-2024, sipas qarkoreve buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 në bashkëpunim edhe me Gjykatat dhe Njësit tjera të KGJK/SKGJK;
- Përgatitjet e kërkesave buxhetore 2022-2024, të cilat kërkesa pas analizimit dhe shqyrtimit nga Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KGJK-së, sipas rekomandimit të komisionit dhe aprovimit nga Këshilli i janë dërguar Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja përmbledhëse e kërkesave buxhetore 2022-2024 për dëgjimet buxhetore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Komisionin për buxhet, Punë dhe Transfere të Kuvendit;
- Përgatitja e kërkesës për rishikim të buxhetit 2021 për KGJK;
- Zotimi dhe shpenzimi i buxhetit për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimeve kapitale sipas planifikimit buxhetor dhe sipas kërkesave nga Njësitë tjera të KGJK/SKGJK dhe gjykatat;
- Regjistrimi i të gjitha transaksioneve në regjistrin e kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe mbaja e evidencës kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në Sekretariatin e KGJK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare e buxhetit dhe të hyrave;
- Përgatitja e raporteve mujore për obligimet e papaguara dhe obligimet kontraktuale si dhe dërgimi i tyre në Thesarin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja e raporteve për procesin e pajtueshmërisë së regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të KGJK-së, barazimi mujor i të hyrave dhe shpenzimeve si dhe dërgimi i tyre në Thesarin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare të KGJK-së për vitin 2020, sipas Rregullores së MF- Nr.01/2017 për "Për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore" dhe udhëzimeve nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Modifikimi i Softuerit për Menaxhimin Elektronik të Hyrave (SEMH) për t'iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të KGJK-së dhe Gjykatave;

- Monitorimi i punës së gjykatave për çështje të buxhetit dhe financave, rreth zbatimit në këtë fushë të Udhëzimit Administrativ për ndarjen e Përgjegjësive të SKGJK-së dhe Gjykatave në çështjet e personelit, buxhetit dhe financave, logjistikës dhe prokurimit dhe
- Bashkëpunimi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm si dhe monitorimi i planit të veprimit për auditimin e vitit 2020. Monitorimi dhe përgatitja e raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

8.1.4 Departamenti i Statistikës

Ky Departament ka përpunuar dhe përpiluar këto raporte statistikore:

- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin e I-rë 2021;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin e II-të dhe Gjashtëmujorin e I-rë 2020;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin III-të dhe Nëntëmujorin e vitit 2021;
- Raporti i përgjithshëm statistikor vjetor 2020;
- Janë kompletuar dosjet për Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, me të dhënat statistikore për tridhjetë e gjashtë (36) muaj për njëqind e nëntëdhjetë e dy (192) gjyqtarë;
- Raportin mbi lëndët e vjetra të gjykatave, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportet statistikore për vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsion, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Integrimeve Evropiane, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprën penale Trafikim me Njerëz, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportet e rregullta për Ambasadën Amerikane për veprën penale Trafikim me Njerëz, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportimi i rregullt në "Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin" për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportimi i rregullt në OSCE, për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportimi i rregullt i zyrtarëve të EULEX-it, për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021 dhe
- Raportimi i rregullt për të gjithë gazetarët e akredituar si dhe OJQ-ve të akredituara.

8.1.5 Departamenti i Logjistikës

Gjatë vitit 2021, janë përgatitur elaboratet e shpronësimit dhe është dërguar kërkesa në Qeverinë e Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të identifikuara për ndërtimin e objekteve të gjykatave themelore në Prizren dhe Pejë, si dhe për shpronësimin e objektit të ish Jugobankës për Gjykatën Themelore në Mitrovice, pjesa jugore.

Janë realizuar disa kërkesa të gjykatave për investimet kapitale që lidhen me riparimet e nevojshme të objekteve dhe ndërtimin e objekteve të reja, janë ndihmuar gjykatat në përdorimin dhe futjen e të dhënave në sistemin elektronik e-pasuria për të gjithë zyrtarët e logjistikës në gjykata si dhe sipas nevojës janë vizituar disa gjykata që kanë mbetur mbrapa në regjistrimin e pasurisë.

Investimet Kapitale

Në kuadër të investimeve kapitale, është punuar në ndërtimin e objektit të gjykatës në Fushë Kosovë, ku vlera e investimeve deri tani në këtë projekt është arritur 708.596.00 €. Punimet janë në fazën finale dhe pritet që në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, gjykata të vendoset në objektin e ri. Është punuar edhe në renovimin dhe mirëmbajtjen e disa objekteve të gjykatave, mirëpo shuma e investimeve ka qenë e vogël, rreth 11.645,00 €.

Janë evidentuar pengesa në shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesave në mungesë të kontratës për shkak mos funksionimit të OSHP-së për lidhjen e kontratës se re. Nuk është arritur realizimi i projekteve për ndërtimin e gjykatave themelore në Prizren dhe Pejë si dhe renovimin e objektit të Gjykatës në Mitrovicë të Jugut, për shkak se Qeveria nuk ka bërë shpronësimin e pronave për fillimin e punimeve në këto objekte të gjykatave. Gjithashtu, projekti në Drenas nuk është filluar për shkak se komuna nuk e ka lejuar një gjë të tillë për shkak se prona gjendet në kontest pronësor.

Furnizimet me material, pajisje dhe inventar nëpër gjykata

Janë përmbushur kërkesat e gjykatave dhe KGJK-së për furnizime me material zyrtar, material të shtypur dhe materiale të tjera të nevojshme. Për këto furnizime, janë shfrytëzuar kontratat e KGJK-së dhe kontratat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Kërkesat për furnizimin me inventar dhe shërbime tjera për zyrtarët brenda KGJK-së dhe gjykatave janë plotësuar duke shfrytëzuar kontratat ekzistuese me operatorët ekonomik të lidhura nga AQP. Janë bërë furnizime me material dhe shërbimet e servisimit dhe të mirëmbajtjes të pajisjeve në objektet të gjykatave. Totali i shpenzimeve të furnizimit dhe shërbimeve të KGJK-së dhe gjykatave gjatë vitit 2021 është si në vijim:

- Furnizimi me inventar: 6.925,00 €;
- Furnizimi me treqind e njëzet (320) kompjuterë të ri;
- Furnizimi me material zyrtar: rreth 94,300.19 €;
- Furnizimi me material të shtypur: rreth 65.040,66 €;
- Mirëmbajtja e ashensorëve: 3.229 €;
- Mirëmbajtja e klimave dhe sistemeve të klimatizimit: rreth 31.000,00 € dhe
- Mirëmbajtja e gjeneratorëve në objektet të gjykatave: rreth 12.000,00 €.

Përdorimi i aplikacionit E-pasuria

Janë asistuar gjykatat në përdorimin e aplikacionit për regjistrimin e pasurisë për vitin 2021 përkundër vështirësive në përdorim, pasi që MPB nuk ka pasur kontratë për mirëmbajtjen e aplikacionit. Në bashkëpunim me zyrtarin e pasurisë në KGJK, janë ofruar rekomandime për zyrtarët e logjistikës dhe të pasurisë në gjykata në përdorimin e sistemit e-pasuria.

Shërbimet në transport dhe mirëmbajte të veturave

KGJK dhe gjykatat kanë pasur në shfrytëzim gjithsejtë, njëqind e tridhjetë (130) automjete. Në gjysmën e dytë të vitit janë marr donacion nga organizata të huaja edhe gjashtë (6) automjete të tjera, pra në fund të vitit kemi pasur gjithsejtë, njëqind e tridhjetë e gjashtë (136) automjete.

Nga totali i automjeteve në përdorim, pesëdhjetë e tre (53) prej tyre janë vetura të marra me qira përmes kontratës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Raporti i shpenzimeve të automjeteve për gjykata dhe KGJK është si në vijim:

Vlera totale e shpenzimeve të krijuara nga automjetet e KGJK-së dhe gjykatave është 379.889,00 €, prej tyre:

- 208.807,00 janë shpenzimet e qirasë së veturave;
- 2.276,00 janë shpenzimet e auto gomave;
- 49.840,00 € janë shpenzimet e servisimit dhe të mirëmbajtës si dhe
- 118.966,00 € janë shpenzime të karburanteve për vetura, ku shpenzimet mesatare të karburantit të veturave për 100 km janë 6.9 litra.

Në përgjithësi, nevojat e gjykatave për shërbimet e transportit me automjete janë plotësuar sa i përket detyrave zyrtare. Është punuar në riorganizimin e transportit për të zvogëluar shpenzimet e automjeteve, me ç'rast KGJK ka ndryshuar Udhëzimin Administrativ për shfrytëzim të automjeteve zyrtare, sipas planifikimeve të Departamentit të Logjistikës për uljen e shpenzimeve dhe kjo ka ndikuar në largimin nga përdorimi i njëzet e nëntë (29) automjeteve të vjetra, të cilat do të shiten përmes ankandit publik.

Raportet e pranimit në Free Balance

Raportet e pranimit të lëndëve që janë regjistruar në Free Balance të cilat dalin nga kontratat me procedura të prokurimit, kanë qenë rreth pesëqind (500) lëndë të regjistruara.

8.1.6 Departamenti i Auditimit të Brendshëm

Departamenti ka përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, siç janë:

- Menaxhimi i depozitave gjyqësore në SKGJK dhe gjykata;
- Menaxhimi i listave të pagave të rregullta dhe jashtë orarit në SKGJK dhe gjykata;
- Menaxhimi i shpenzimeve me (pa proceduar prokurimit në SKGJK dhe gjykata);
- Menaxhimi i proceduarave të prokurimit në investime kapitale në SKGJK;
- Menaxhimi i të hyrave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore dhe të procedurës përmbarimore në SKGJK dhe gjykata si dhe
- Menaxhimi i trajnimeve dhe Avancimet në SKGJK dhe gjykata.

Monitorimi dhe implementimi i rekomandimeve nëpër gjykata dhe SKGJK, kanë qenë këto objektiva:

- Menaxhimi i Transportit në SKGJK dhe gjykata;
- Menaxhimi i Pasurive Jo financiare në SKGJK dhe gjykata si dhe
- Menaxhimi i proceduarave rekrutuese të personelit dhe kontrata e veçantë në SKGJK dhe gjykata;

Është bërë auditimi (Ad-Hoc) me kërkesë të menaxhmentit të SKGJK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë, lidhur me ekzekutimin e Pagesave për ekspert, avokat, gjyqtarë porotë dhe kthim të depozitave.

Ky Departament, ka hartuar dhe dorëzuar brenda afatit të caktuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2021-2023 dhe Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2021.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të DAB, që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të

shtimit të kontrollit, që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim më efikas në gjykata dhe departamente, apo njësive përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Është realizuar plani për vitin 2021 dhe është përcjellë zbatimi i rekomandimeve, ku janë përfunduar gjithsejt, nëntë (9) raporte të auditimit sipas planit dhe një (1) raport me kërkesë ad-hoc. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, ka mbajtur takime dhe ka bërë mbikëqyrjen e planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

Në fund të vitit, janë përgatitur dhe dorëzuar pas aprovimit nga ZKA tek Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Plani Strategjik (2022-2024) dhe Plani Vjetor të Auditimit të Brendshëm për viti 2022.

8.1.7 Zyra për Teknologji Informative dhe Komunikim

Zyra për Teknologji Informative, përveç punës së rregullt të mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të TIK që ka në përdorim në KGJK dhe gjykata, gjatë vitit ka qenë e angazhuar më së shumti në aktivitete për zbatimin e Projektit të Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL). Zyra ka qenë e angazhuar edhe në aktivitete që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit të audio dhe video incizimit në gjykata, implementimi i të cilit është duke u zbatuar dhe financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Objektivi i vënies në zbatim të projekteve me rëndësi të TIK-ut në gjykata është rritja e efikasitetit në punë, transparencës dhe llogaridhënies. Kjo do të rezultojë në shkurtimin e afateve të kryerjes së lëndëve dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetar. Në kuadër të zbatimit të projektit të SMIL janë arritur me sukses të implementohen aktivitete të rëndësishme të parapara në projekt.

Implementimi i Projektit SMIL dhe ofrimi i trajnimeve për përdorues

Me sukses është vënë në zbatim SMIL në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, me ç’rast në Gjykatën e Apelit janë trajnuar njëqind e tridhjetë e katër (134) përdorues dhe në

Gjykatën Supreme të Kosovës janë trajnuar dyzet e dy (42) përdorues lidhur me përdorimin e SMIL. Është arritur që sistemi i SMIL për të gjitha lëmit të vihet në zbatim në tre instancat gjyqësore.

Pa vënë në zbatim, sistemi i SMIL-it është vetëm në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërsa për DHPGJS është në fazat e fundit të testimit dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, do të vihet në zbatim dhe me këtë të përmbyllet vënia e SMIL në zbatim në të gjitha gjykatat e vendit. Kjo do të mundësoj procedimin e lëndëve në formë elektronike për gjitha gjykatat. Po ashtu, do të sigurohet shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike dhe raportimi me të dhëna të sakta dhe mundësia për të rritur numrin e raporteve dhe të dhënave që do të publikohen.

Largimi i regjistrave manual nga përdorimi në gjykata

Pas pilotimit të suksesshëm të largimit të regjistrave manual nga përdorimi në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe me vendim të KGJK-së Ref: KGJK.Nr.265/2020 është zbatuar plani për largimin e regjistrave manual nga përdorimi në të gjitha gjykatat. Për këtë qëllim, në SMIL janë zhvilluar regjistrat elektronik të cilët do të zëvendësojnë regjistrat manual. Për gjykatat themelore janë zhvilluar dhjetë (10) regjistra elektronik, për Gjykatën e Apelit pesë (5) regjistra dhe për Gjykatën Supreme tre (3) regjistra, me qëllim të largimit të përdorimit të regjistrave manual në të gjitha gjykatat.

Shpërndarja automatike e lëndëve

Shpërndarja automatike e lëndëve është implementuar dhe është duke funksionuar në të gjitha gjykatat themelore. Në Gjykatën e Apelit, ky funksion është implementuar në dhjetor të vitit 2021, ndërsa në Gjykatën Supreme do të implementohet në tremujorin e parë të vitit 2022.

Ndërlidhja elektronike ndërmjet gjykatës dhe prokurorisë

Ndërlidhja elektronike gjykatë-prokurori dhe anasjelltas është funksionale. Funksionet e reja të ndërlidhjes elektronike gjykatë-prokurori dhe anasjelltas të cilat janë zhvilluar dhe janë implementuar gjatë periudhës raportuese, janë: urdhri ndëshkimor, veçimi i procedurës, bashkimi i lëndëve si dhe validimi i të dhënave që shkëmbehen.

Këto janë dokumentet dhe veprimet e fundit që janë realizuar me ndërlidhje dhe me këtë kompletohet interoperabilitieti i Projektit SMIL, gjykatë me prokurori. Kjo do të mundësoj tërë komunikimin gjykatë prokurori dhe anasjelltas në formë elektronike.

Interoperabiliteti i SMIL, do të rrisë saktësinë e të dhënave dhe do të lehtësoj në masë të madhe punën e stafit në gjykatë dhe prokurori, kjo pasi të dhënat do të futen një herë në sistem dhe përdoren pastaj sipas nevojës në gjykata apo prokurori. Gjithashtu, do të ulet edhe kosto e kopjimit dhe printimit të shkresave të lëndëve.

Zhvillimi i raporteve statistikore dhe dashboard

Janë hartuar dhe zhvilluar në SMIL raporte të avancuara statistikore me një numër të madh të të dhënave statistikore. Këto raporte ofrojnë një gamë të gjerë të dhënash, duke përfshirë numrin e lëndëve të pazgjidhura, vjetërsinë e lëndëve në pritje, numrin e lëndëve të zgjidhura, kohëzgjatjen e procedurave, numrin e seancave të mbajtura për lëndë të zgjidhura, etj. Në raporte, janë përfshirë edhe indikatorët e CEPEJ për matjen dhe vlerësimin e gjyqtarëve dhe performancës së gjykatave. Për të përmirësuar raportet statistikore të SMIL dhe për të siguruar që të gjithë treguesit e CEPEJ, janë përfshirë në mënyrën më të mirë të mundshme në raportet e SMIL, Projekti SMIL në bashkëpunim me JSSP dhe KoSEJ II, kanë krijuar një grup të përbashkët ekspertësh për të analizuar raportet aktuale të SMIL dhe kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e këtyre raporteve. Sipas planit, projekti ka angazhuar një ekspert ndërkombëtar me ekspertizë në statistikat gjyqësore, i cili do të punojë së bashku me ekspertët e projektit KoSEJ II dhe Projektit JSSP.

Ndërlidhja e SMIL me ueb portalin e gjykatave

Pas lansimit të veglës në portalin gjyqësor, palët përmes numrit unik të lëndës mund të kërkojnë dhe të gjejnë informacionin në lidhje me statusin e lëndës së tyre në gjykatë. Një veçori e re e futur në këtë funksion është edhe orari i seancave gjyqësore, të cilat publikohen automatikisht nga sistemi SMIL në ueb portalin e gjykatave. Këto funksione të reja, kanë ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.

8.1.8 Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit ka zhvilluar dhe publikuar gjithsejtë, njëzet e gjashtë (26) aktivitete të prokurimit publik, përfshirë: Punë/Shërbime dhe Furnizim për KGJK-në me njësitë e saj dhe për të gjitha nivelet e gjykatave.

Janë dorëzuar katërqind (400) dosje të tenderit për ofertim, për operatorët ekonomik të cilët kanë shprehur interesim për njëzet e gjashtë (26) aktivitetet e prokurimit publik, të publikuara në platformën 'e-prokurimi' nga zyra e prokurimit të SKGJK-së.

Në procesin e hapjes së ofertave nga operatorët ekonomik, janë pranuar gjashtëdhjetë e pesë (65) oferta. Nga njëzet e gjashtë (26) procedura të prokurimit publik të zhvilluara, janë organizuar njëzet e katër (24) komisione për hapjen e ofertave, komfor nenit 58, të LPP-së dhe njëzet e katër (24) komisione të vlerësimit të ofertave, sipas nenit 59. Njëzet e dy (22) aktivitete të prokurimit publik janë vlerësuar dhe nga ato njëzet (20) aktivitete janë lidhur kontrata publike, pa asnjë ankesë.

Për një (1) aktivitet të prokurimit publik, ka pasur ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, e cila ka të bëjë me servisimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes qendrore në objekte të gjykatave dhe SKGJK-së.
Kontratat publike të cilat janë zhvilluar përfshijnë:

- Kontrata me procedurë të negociuar: një (1);
- Kontrata me vlerë të mesme: nëntë (9);
- Kontrata me vlerë të kuotimit: tri (3) dhe
- Kontrata me vlerë minimale: shtatë (7).

Ato janë:

- Furnizim me Material Higjenik për gjykata: Kontrata publike kornizë me vlerë të mesme: Mirëmbajtja higjienike e Objektit të Sekretariatit të KGJK-së, Graçanicë, dhe objektin e divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut;
- Kontrata publike kornizë me vlerë të mesme: Dhënia në shfrytëzim e hapësirës brenda objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, për shërbim me pije;

- Kontrata publike vlerë të mesme: Shërbimeve ‘backup’ të rrjetit WAN;
- Kontrata publike kornizë vlerë të mesme: Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të TI-së për SKGJK, Zyra për Vlerësim dhe Verifikim (ZVVGJ), Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore (NJSHPGJ) dhe të gjitha nivelet e gjykatave;
- Kontrata publike kornizë vlerë të mesme: Transporti i punëtorëve të gjykatave në relacionin Mitrovicë e Jugut - Mitrovicë e Veriut dhe anasjelltas;
- Kontrata publike kornizë vlerë të Mesme: Shërbime për mirëmbajtje dhe përmirësime në ‘Softuer’ për të hyra gjyqësore;
- Kontrata publike vlerë e mesme: Furnizim me licenca softuerike;
- Servisimi i klimave dhe sistemi i klimatizimit dhe ventilimit në gjykata dhe SKGJK;
- Kontrata publike vlerës kuotimit: Rregullimi i auto parkingut të KGJK-së;
- Kontrata publike vlerës kuotimit: Vlerësimi teknik i objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Drenas, për mbi ndërtimin e një kati;
- Kontrata publike të vlerës kuotimit: Furnizimi me notes, kimik, kalendar tavoline dhe qese të letrës të gjitha me logo të KGJK-së për zyrtarët e KGJK-së dhe gjykatave;
- Kontrata publike vlerës minimale: Publikimi i pozitave të lira në mjetet e informimit publik për SKGJK-në dhe gjykata;
- Kontrata publike të vlerës minimale: Rrënimi i barakave në parking mbrapa KGJK-së;
- Kontrata publike të vlerës minimale furnizim: Blerjen e dhuratave dekorative për mirënjohje për Zyrën e Kryesuesit të KGJK-së;
- Kontrata publike të vlerës minimale: Rregullimi i zyrës në objektin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Kontrata publike vlerës minimale: Shërbimin e televizioneve kabllovike dhe Internetit për KGJK-në;
- Kontrata publike të vlerës minimale: Sigurimi i auto përgjegjësisë për dy (2) automjete të KGJK-së;
- Proceduara e negociuar te vlerës minimale: Punët shtesë - Rregullimi i auto parkingut të KGJK-së;
- Kontrata publike të vlerës Minimale: Rregullimi i ngrohjes qendrore në objektin e Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti;

Janë bërë edhe dy (2) shkëputje të një-anshme të kontratave publike kornizë për operatorë e pa përgjegjshëm ekonomik të cilët janë penalizuar me ekzekutimet e sigurimeve:

- ✓ Kontrata publike kornizë me vlerë të Mesme: Transporti i punëtorëve të gjykatave në relacionin Mitrovicë e Jugut - Mitrovicë e Veriut dhe anasjelltas.
- ✓ Kontrata publike kornizë me vlerë të Mesme: Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve në SKGJK dhe gjykata me numër identifikues: 328-19-7946-2-2-1.

8.1.9 Zyra për Evidencë Penale

KGJK ka vazhduar aktivitetet në funksion të Ngritjes dhe Konsolidimit të Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës - SQEPK (Regjistri Qendrori i Evidencës Penale të personave të Dënuar).

Aktivitetet janë si në vijim:

- Zyra Qendrore e Evidencës Penale (ZQEP), forcoi kapacitetet e saj operacionale dhe filloi ushtrimin e rregullt të kompetencave të parapara me mandatin e saj;
- KGJK ka zhvilluar dhe finalizuar procesin e emërimit të resurseve të nevojshme njerëzore në të gjitha gjykatat e vendit me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit;
- Në të gjitha gjykatat themelore në nivel vendi, ka vazhduar procesi i regjistrimit të lëndëve të reja penale (lëndëve të përfunduara me Aktgjykime të plotfuqishme gjyqësore) në data bazën qendrore të SQEP-së, rrjedhimisht gjatë vitit 2021, në sistem u proceduan gjithsejtë: 30428 lëndë të reja penale;
- Ka vazhduar procesi i ngritjes dhe ndërtimit të Data bazës Qendrore të Evidencës Penale, kjo bazë e të dhënave tani është operative në të gjitha gjykatat e vendit;
- Me qëllim të operimit të plotë të SQEP-së, janë finalizuar shumica e procedurave standarde të veprimit, të cilat përfshijnë proceset kryesore në kuadër të operimit të sistemit;

- Në funksion të implementimit të SQEP-së, KGJK ka finalizuar aktivitetet të cilat i referohen:
  - Fillimit të procesit të Rehabilitimit Ligjor;
  - Procesit të funksionimit të sistemit të ri të certifikatave të gjendjes penale dhe
  - Procesit të regjistrimit të aktgjykimeve të huaja penale.

  Po ashtu, ka filluar edhe procesi i skanimit të të gjitha aktgjykimeve penale të formës së prerë në gjykatat e vendit;
- ZQEP, ishte pjesë aktive e procesit të hartimit të politikave dhe procedurave të veprimit të cilat i referohen konsolidimit dhe funksionimit të SQEPK-së dhe
- Zyra ka vazhduar ofrimin e të dhënave mbi gjendjen penale, për subjektet dhe institucionet e ndryshme të vendit.

Kjo zyrë, ka realizuar një bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante shtetërore si: Ministrinë e Drejtësisë, MPB, Agjencinë e Regjistrimit Civil, Ministrinë e Administratës Publike, etj.

Situata Aktuale në Data Bazën Qendrore të Evidencës Penale

Në tabelën e mëposhtme, përfshihen disa të dhëna të përgjithësuara mbi gjendjen aktuale në data bazën e SQEP dhe informacione të përgjithshme nga fushë veprimtaria e zyrës.

1	**Nr. total i rasteve në Data Bazë**		**309647**
2	Nr. total i personave te dënuar në Data Bazë		**218134**
3	Nr. total i rasteve të regjistruara në Data Bazë gjatë vitit 2021		**30428**
4	Nr. total i personave të Dënuar gjatë vitit 2021		**14764**
5	Nr. i rasteve të evidentuara në gjykata themelore, me degët e tyre (lëndë të regjistruara në vitin 2021)	Gjykata Themelore Prishtinë	**10378**
		Gjykata Themelore Prizren	**4140**
		Gjykata Themelore Ferizaj	**2793**
		Gjykata Themelore Pejë	**2810**
		Gjykata Themelore Gjilan	**3854**
		Gjykata Themelore Mitrovicë	**2692**
		Gjykata Themelore Gjakovë	**3761**
6	Shërbime të ofruara të gjendjes penale		**6086**
7	**Numri i aktgjykimeve të skanuara**		**23027**

8.1.10 Integrimi Evropian

Një ndër prioritetet kyçe të Marrëveshje së Stabilizim Asociimit (MSA) është zbatimi dhe respektimi i plotë i sundimit të ligjit. KGJK është një ndër kontribuuesit kryesor dhe fondamental në procesin e Integrimit Evropian, në veçanti në sektorin e sundimit të ligjit. KGJK me qëllim të zbatimit dhe përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, ka ofruar me kohë raportime të rregullta mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, ka ndërmarrë masat e duhura për përmbushjen e këtyre obligimeve dhe realizimin e reformave në sistemin gjyqësor duke ofruar mbështetje në bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të cilat i përkasin fushës së sistemit gjyqësor dhe ndërlidhen me Integrimet Evropiane.

Kjo zyrë ka koordinuar aktivitetet lidhur me zbatimin e obligimeve të dala nga MSA, ka monitoruar dhe raportuar zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, ka koordinuar aktivitetet e KGJK-së për mbështetje financiare nga Instrumenti i Para- Anëtarësimit (IPA), si dhe ka ofruar raportime të rregullta në lidhje me përmbushjen e obligimeve që KGJK ka marrë përsipër në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, Agjendën për Reforma Evropiane dhe Programin për Reforma në Ekonomi. Po ashtu, ka kontribuar në shkëmbimin e informatave me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në funksion të procesit të integrimit evropian për fushë-veprimtarinë e sistemit gjyqësor si dhe bashkëpunuar me të gjitha projektet të cilat e mbështesin KGJK-në, në drejtim të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës së sistemit gjyqësor.

8.1.11 Zyra për Mbështetje dhe Përkthime

Zyra për Mbështetje dhe Përkthime, ka përkthyer të gjitha materialet që ka pranuar si: vendime, akte normative, rregullore, udhëzime, agjenda, njoftime, komunikata për media si dhe raporte të ndryshme të SKGJK-së.

Ka ofruar përkthim simultan dhe konsekutiv në të gjitha takimet e Këshillit dhe komisionet e tij si dhe në komisionet intervistuese për gjyqtarë. Gjithsejtë, ka përkthyer rreth 4592 faqe përkthim me shkrim dhe rreth 209 orë përkthim simultan dhe/ose konsekutiv.

Kjo Zyrë, ka shërbyer si anëtare e rrjetit dhe e bordit për shërbime gjuhësore në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhë (ZKGJ) dhe vlen të ceket se nuk ka pranuar asnjë ankesë nga qytetarët për mos respektimin e gjuhëve zyrtare nga gjykatat e Kosovës.

Janë organizuar trajnime me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtar si UNDP dhe IOM për përkthyesit e të gjitha gjykatave të Kosovës dhe SKGJK-së, përmes të cilave është synuar rritja e cilësisë së përkthimeve dhe standardizimi i terminologjisë juridike gjyqësore të përkthimeve. Si rezultat i trajnimit me UNDP, përkthyesit e të gjitha gjykatave së bashku me ekspertin e UNDP-së, kanë hartuar edhe një fjalor të fushave të specializuara si: biznes, bujqësi, dhunë në familje, mjekësi dhe çështje pronësore.
Ofrimi i mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve ku UNDP dhe UNMIK, kanë ofruar mbështetje me ofrimin e përkthyesve me kontratë mbi shërbime në Gjykatën Themelore në Prishtinë, të cilët kanë përkthyer dosje të lëndëve të vjetërsuara dhe kanë ofruar përkthim konsekutiv në seanca te ndryshme gjyqësore.

Zyra ka realizuar vizita në teren në të gjitha gjykatat themelore, për të diskutuar sfidat dhe çështjet e shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit në sektorin e drejtësisë. Ka mbajtur takim koordinues me donatorë për aktivitetet e planifikuara për shërbimet e përkthimit dhe interpretimit në sektorin e drejtësisë ku janë prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit për shërbimet e përkthimit dhe interpretimit në sektorin e drejtësisë, të financuar dhe kryesuar nga Projekti EUKOJUST.

Po ashtu, kjo zyrë është angazhuar në mbështetjen e Këshillit në organizmin dhe përpilimin e listave për anëtarë të Komisionit Vlerësues për Përkthyes dhe Interpret gjyqësor.

8.1.12 Komunikimi me Publikun

Komunikimi me publikun, siguron transparencë dhe qasje publike për punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Sekretariatit të Këshillit, duke ofruar informata të nevojshme dhe qasje në dokumentet publike me kërkesë të qytetarëve, mediave dhe OJQ-ve.

Të gjitha aktivitetet e Këshillit mbështeten në vazhdimësi, duke përpiluar: ftesa, njoftime, sqarime, reagime, komunikata, të cilat publikohen ueb faqe, rrjetin social Facebook dhe u dërgohen mediave.

Në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme për informim, ka vazhduar mirëmbajtja e përmbajtjes së ueb faqes së gjyqësorit, e cila i është përshtatur mirë përdoruesve dhe publikut, në qasjen e informatave të nevojshme si dhe mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare të KGJK-së në rrjetin social, Facebook.

KGJK Facebook

Ndjekës në total:

9,577

Janë publikuar gjithsejtë, njëqind e pesëdhjetë e shtatë (157) komunikata dhe njoftime. Në faqen zyrtare në Facebook, janë publikuar gjithsejtë, njëqind e shtatëdhjetë e tre (173) postime.

Më poshtë, gjeni diagrame që shfaqin të dhëna demografike që bazohen në moshën dhe gjininë që ndjekësit e faqes ofrojnë në profilet e tyre si dhe top tre (3) lokacionet nga të cilat vijnë:



VENDI	Nr.ndjekësve
Kosovë	8,388
Gjermani	160
Zvicër	86

Viti i pandemisë COVID-19, barti me vete vështirësitë për sistemin gjyqësor, ku edhe është shtuar akoma edhe më shumë nevoja për të komunikuar në mënyrë profesionale, të hapur dhe cilësore me publikun.

Në këtë kontest, në mbështetje të projekteve të USAID-it dhe nën garancinë e ligjit për të drejtën për informimit vlen të përmendet angazhimi i SKGJK, i cili vjen i materializuar me hartimin e Draft Strategjisë së Komunikimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022 – 2024, e cila synon të shërbejë si një plan i standardizuar dhe i strukturuar për KGJK-në dhe Gjykatat me qëllim të përmirësimit të informimit të publikut për punën e gjyqësorit dhe fuqizimit të partneritetit efektiv me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

KGJK në bashkëpunim me projektet e USAID, Aktiviteti për Drejtësi dhe Drejtësia Komerciale ka publikuar video/postera shpjegues për publik lidhur me informata dhe shërbime brenda gjykatave, grafika dhe raporte të ndryshme. Në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, KGJK ka trajtuar një mori kërkesash për informacione të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare duke ju kthyer përgjigje, brenda një afati të arsyeshëm të gjithë kërkuesve të informacionit.

Përveç kërkesave të vazhdueshme të mediave të shkruara dhe vizuale, iu është përgjigjur të gjitha OJQ-ve që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, të cilat monitorjnë punën e gjyqësorit. KGJK ka vazhduar mbështetjen e të gjitha organizatave joqeveritare, duke filluar nga GLPS, Lëvizja Fol, BIRN, IKD, KDI, AVONET, KOMF, YIHR-KS, RoLAG, INJECT, etj. Për shkak të gjendjes me pandeminë COVID-19, këtë vit është anuluar Konferenca e Dhjetë Vjetore Gjyqësore.

KGJK synon që të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe mediat, prandaj Këshilli vazhdon t'i merr me seriozitet të gjitha rekomandimet nga organizatat e shoqërisë civile dhe aktivitetet të cilat kanë për synim avancimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës.

8.1.13 Certifikuesi

Deri në fund të vitit 2020, nga Departamenti për Buxhet dhe Financa janë pranuar gjithsejtë: 1386 lëndë në shumë prej 1,918.697.50 € dhe të gjitha janë aprovuar, nuk është bartur asnjë obligim për vitin 2021. Numri i lëndëve të pranuara në zyrën e Certifikuesit deri më datën 30 dhjetor 2021, është gjithsejtë: 1536 lëndë në shumë prej 2,452,070,11 € dhe të gjitha lëndët e pranuara janë aprovuar. Lëndët e aprovuara kanë qenë të kategorive të ndryshme ekonomike si: shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime, komunali, subvencione, etj.

8.1.14 Arkiva

Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkivës në SKGJK, ka realizuar aktivitete bazuar në dispozitat juridike të Rregullores për Protokollimin e Dokumenteve, Administrimin dhe Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor të KGJK-së, si:

Pranimi i shkresës në mënyrë efikase me letër nga pala, përmes shërbimit postar, nga dorëzuesi i shkresave, apo në formë elektronike në adresën e KGJK-së. Ndërsa, lëndët me urgjencë të shkresave të cilat janë të lidhura me afat të caktuar që janë adresuar jashtë Këshillit, nga zyra e arkivit janë shpërndarë me kohë.

Në protokollin e SKGJK-së, janë regjistruar gjithsejtë: 1995 shkresa dhe në protokollin e KGJK-së, 1045 shkresa. Përmes librit nëpër gjykata të regjionit, janë dorëzuar gjithsejtë: 788 shkresa/vendime, janë arkivuar 930 lëndë, janë dorëzuar/shpërndarë përmes librit dorëzues, 700 shkresa/vendime në institucione të ndryshme dhe në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Janë regjistruar aplikacione që kanë aplikuar për gjyqtarë dhe bashkëpunëtor profesional, gjithsejtë: 1.725. Në librin e faturimit janë regjistruar gjithsejtë 730 fatura, janë pranuar aplikacione që kanë aplikuar në gjyqësorin e Kosovës, gjithsejtë: 325. Përmes postës (PTK) janë shpërndarë 325 shkresa/vendime dhe janë regjistruar gjithsejtë: 162 lëndë për kompensim dëmi.

Është arritur kompensimi i shtesave për anëtarët e KGJK-së dhe administratën e gjykatave sipas Ligjit dhe Rregullores siç janë: ndryshime, apo pranime të reja në punë, heqje dorë vullnetare nga puna, largimet nga puna, avancimet, transferim, pushimet pa pagesë, pushimet mjekësore të cilat janë dërguar dhe realizuar gjithsejtë: 996 pagesa në Pay-rollit në Divizionin e Pagave në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Për punën jashtë orarit për gjyqtarët dhe stafin administrative për gjykatat e Kosovës janë realizuar/kompensuar dhe dërguar për pagesë gjithsejtë: 2.875 kërkesa në Divizionin e Pagave në Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Po ashtu, edhe shtesat në vlerë prej 50 euro janë realizuar për çdo tre (3) muaj për vitin 2021, nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, duke ju referuar vendimit përkatës së Qeverisë.

PJESA E PESTË

9. PANELI PËR LIRIM ME KUSHT

Paneli për Lirim me Kusht (PLK), ka organizuar mbajtjen e seancave të Panelit dhe kontrollimin e rasteve për kualifikim për shqyrtim për lirim me kusht. Paneli ka mbajtur gjithsejtë, pesëdhjetë e dy (52) seanca dhe vëmendje e posaçme i është kushtuar afateve ligjore të shqyrtimit të rasteve. Për çdo muaj, janë mbajtur seancat dhe janë shqyrtuar dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) raste në çdo seancë, me qëllim të respektimit të afateve ligjore, përkatësisht nenit 10 të Rregullores së Punës. Janë organizuar seanca për të respektuar të drejtën e të dënuarave për një shqyrtim në afat të arsyeshëm kohor.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vëzhguar dhe monitoruar procedurat e implementimit të lirimit me kusht në të gjitha fazat e procedurës, po ashtu edhe Misioni i EULEX-it ka monitoruar disa raste me kërkesë të tyre.

Në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, PLK ka ofruar qasje dhe bashkëpunim për OJQ-të të cilat monitorojnë zbatimin e lirimit me kusht. Nga data 1 mars 2019, Institucionet Korrektuese i parashtrojnë dosjet në mënyrë elektronike dhe kjo ka ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të procedurës për lirim me kusht.

PLK ka pasur në punë tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë (869) kërkesa, prej tyre shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë (796) kërkesa janë pranuar nga Institucionet Korrektuese në vitin 2021 dhe shtatëdhjetë e tri kërkesa (73) janë bartur nga viti 2020.

Gjatë vitit 2021, janë shqyrtuar shtatëqind e shtatëdhjetë e një (771) kërkesa për lirim me kusht dhe për këto kërkesa janë vendosur në këto mënyra:

- Me aktvendim lirues: dyqind e tridhjetë e shtatë (237) raste;
- Me aktvendim refuzues: pesëqind e gjashtë (506) raste;
- Janë pushuar procedurat e shqyrtimit për lirim me kusht për njëzet e një (21) raste, për arsye të lirimit të parakohshëm nga ana e gjykatave themelore;
- Është hedhur poshtë shqyrtimit i kërkesave për gjashtë (6) raste;
- Është shtyrë një (1) rast për shqyrtim dhe
- Nëntëdhjetë e tetë (98) kërkesa, janë bartur për shqyrtim në vitin 2022.

Numri i kërkesave të shqyrtuara sipas gjinisë është shtatëqind e dyzet e nëntë (749) meshkuj, ndërsa njëzetë e dy (22) femra. Paneli ka trajtuar edhe kërkesa të personave të dënuar me burgim për të mitur si dhe ka pranuar pesëqind e njëzetë e tetë (528) raporte të zyrtarëve sprovues lidhur me zbatimin e lirimit me kusht.

10. NJËSIA E INSPEKTIMIT GJYQËSOR

Njësia e Inspektimit Gjyqësor (NJIGJ), ndihmon Komisionin për Administrimin e Gjykatave si dhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, në vlerësimin e punës së gjykatave.

NJIGJ ka zhvilluar këto aktivitete të punës:

- Ka bashkëpunuar me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK) për miratimin e listës me shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre, të cilat krijohen nga gjyqësori i Kosovës, e cila mbështetjen e kishte në zbatimin e Rregullores së Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB) Nr.05/2020;
- Ka draftuar Listë regjistrimin e lëndëve Kundërvajtëse të cilat kanë plotësuar kushtet për asgjësim, e cila është miratuar nga KGJK;
- Ka draftuar Udhëzimin Administrativ të KGJK-së nr.02/2021, lidhur me zbatimin e Listës me Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre, të cilat krijohen nga gjyqësori i Kosovës. Ky Udhëzim është miratuar nga KGJK;
- Është mbajtur takim i përbashkët me administratorët e gjykatave, lidhur me kornizën fillestare rregullative për çështje të arkivave të gjykatave;
- Janë pranuar vendimet nga gjykatat themelore, me të cilat ishin caktuar komisionet mbikëqyrëse për regjistrimin dhe asgjësimin e lëndëve të kundërvajtjes, të cilave i kishte skaduar afati i ruajtjes;
- Janë mbajtur takime këshilluese në gjykatat themelore me komisionet dhe stafin ndihmës për regjistrimin e lëndëve kundërvajtëse të cilat do të asgjësoheshin;
- Është bërë inspektim në gjykatat themelore, lidhur me fillimin e procesit të regjistrimit të lëndëve kundërvajtëse të cilat do të asgjësoheshin;
- Është angazhuar për çështjen e largimit të lëndëve gjyqësore të ish Gjykatës Komunale të Prizrenit, për t'i kaluar në objektin e Divizionit për Kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Prizren;
- Ka grumbulluar (tërhequr) vulat e vjetra (jashtë përdorimit) të cilat ishin përdorur nga gjykatat e Kosovës, nga viti 1946 deri më 31 dhjetor 2012;
- Ka regjistruar (faqosur) të gjitha vulat të cilat janë në përdorim në të gjitha gjykatat;

- Në bashkëpunim me Departamentin e Logjistikës, është angazhuar në hartimin e Raportit për vonesat në shpërndarje të shkresave gjyqësore nga ana e Postës së Kosovës dhe Korrierëve të gjykatave;
- Në bashkëpunim me njësitë tjera administrative të KGJK-së, është angazhuar në auditim të lëndëve në ekzekutimet penale dhe kundërvajtëse;
- Ka përgatitur Draft Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e NJIGJ;

Ka ndihmuar dhe kryer sekretarinë në Komisionin për Administrimin e Gjykatave, në këto çështje:

- Ka përgatitur dhe organizuar gjashtë (6) takime pune të rregullta dhe tre (3) takime konsultative dhe
- Ka përgatitur dhe draftuar për KAGJ-in memorandume shpjeguese dhe rekomandime për:
    - Krijimin e komisioneve për vlerësimin dhe testimin e kandidatëve për interpretues dhe përkthyes gjyqësorë;
    - Formimin e Grupit Punues për shqyrtimin dhe finalizimin e Draft Rregullores për caktimin e normës së punës së gjyqtarëve;
    - Miratimin e Formularit për kompensimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike dhe nevojën për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.09/2014;
    - Draftimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/202, për zbatimin e Rregullores së Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB)Nr.05/2020, për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre, të cilat krijohen nga Gjyqësori i Kosovës;
    - Listën e regjistrimit të lëndëve të Kundërvajtjes të cilat kanë plotësuar kushtet për asgjësim;
    - Themelimin e grupit punues për standardizimin e formave të vendimeve procedurale;
    - Miratimin e Planit të Punës së Njësisë së Inspektimit Gjyqësor për vitin 2022 dhe
    - Zbatimin e Vendimit KGJK.nr.291/2021, datë 18 tetor 2021, me ç'rast ka kërkuar nga kryetarët e gjykatave që të kontribuojnë me propozime tyre, për të cilat mendojnë që duhet filluar rishqyrtimin në tërësi të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave.

Ka ndihmuar dhe kryer sekretarinë në Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve në këto çështje:

- Mbajtjen e nëntë (9) seancave plenare;
- Ka përgatitur njëqind e dyzet e katër (144) dosje për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, sipas grupeve:
  - Për gjyqtarët me mandat fillestar: tridhjetë e shtatë (37) dosje;
  - Për gjyqtarët në vlerësim të rregullt: dyzet e tetë (48) dosje dhe
  - Për gjyqtarët në ngritje në detyrë: pesëdhjetë e nëntë (59) dosje.

11. NJËSIA PËR MBËSHTETJEN E KOMISIONEVE PËR REKRUTIM, AVANCIM DHE DISIPLINIM

Kjo njësi, aktivitetin e saj e kryen në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjit për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Gjykatat, Rregulloreve dhe akteve tjera normative të aprovuara nga ana e KGJK-së, dhe duke u bazuar në rekomandimet e KIEVIT për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore.

Njësia, ka kryer aktivitete që ndërlidhen me trajtimin e kandidatëve të mundshëm të cilët kanë aplikuar në konkurset e shpallura nga KGJK për pozitat gjyqtar, në nivel të gjykatave themelore, për pozitat bashkëpunëtor profesional si dhe konkurset tjera të brendshme për ngritje në detyrë të gjyqtarëve.

Përgjegjësitë e Njësisë janë fokusuar në shqyrtimin, analizimin, verifikimin, hetimin, përpilimin e raporteve me shkrim dhe sigurimin e të dhënave për kandidatët të cilët arrijnë t'i përmbushin kriteret formale për pozitën përkatëse, në mënyrë që të lehtësojnë punën e Komisioneve për Emërim, gjegjësisht rekrutuese, dhe më qëllim që emërimet të bëhen mbi bazën e meritokracisë.

Për të siguruar dhe verifikuar informatat e duhura lidhur me kandidatët, kjo Njësi ka bashkëpunuar me gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Agjencinë Kundër Korrupsion, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë për Regjistrimin e bizneseve, Agjencinë Kosovare të Pronës, Administratën Tatimore të Kosovës, Komunat dhe Ministritë e ndryshme, Odën e Avokatëve, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Komisionin Qendror Zgjedhor, etj.

Mes tjerash, ka bërë pranimin, regjistrimin dhe kompletimin e aplikacioneve në bashkëpunim me kandidatët, si dhe përgatitjen e aplikacioneve në formë fizike dhe elektronike për t'u shqyrtuar nga Komisioni Vlerësues (rekrutues/ngritje në detyrë), krijimin e dosjes personale të kandidatit, ruajtjen, dhënien e saj për shikim nga komisioni i parë (komisioni rekrutues/ngritje në detyrë), komisionin e dytë (komisioni për rishqyrtim) sipas ankesave; pranimin e ankesave të rregullta dhe të parregullta, kompletimin, regjistrimin e tyre; përgatitjen e tyre për shqyrtim së bashku me materialin përcjellës (prova etj.); vlerësimin e tyre, nxjerrjen e pretendimeve dhe propozimeve të kandidatëve ankues nga ankesa, mbajtjen e procesverbalit të takimeve të komisioneve; aranzhimin dhe përgatitja e takimeve të komisioneve.

Mes tjerash, ka bërë përgatitjen dhe përpilimin e vendimeve të dala nga vendimet burimore të komisioneve; dërgimin individual të këtyre vendimeve/njoftimeve të kandidatëve; përgatitjen e listave përfundimtare pas çdo faze të procesit rekrutues, apo edhe ngritjes në detyrë si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të KGJK-së.

Kjo Njësi, ka organizuar dhe mbështetur proceset lidhur me konkurset e shpallura nga KGJK, si në vijim:

- Konkurs i brendshëm për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Prishtinë - dega Lipjan;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore Ferizaj;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Gjakovë – dega Rahovec;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Gjakovë – dega Malishevë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Mitrovicë – dega Vushtrri;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Mitrovicë – dega Skenderaj;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Pejë – dega Deçan;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Pejë – dega Istog;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Pejë – dega Klinë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore Prizren;

- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Prizren – dega Dragash;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Prizren – dega Suharekë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;
- Konkurs i brendshëm për gjyqtarë Gjykata e Apelit - Divizioni i Mitrovicës;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Gjilan – dega Novobërdë;
- Konkurs i brendshëm për kryetar të Gjykatës së Apelit;
- Konkurs i brendshëm për gjyqtarë Gjykata Supreme e Kosovës;
- Konkurs i brendshëm për gjyqtarë Gjykata e Apelit;
- Konkurs i brendshëm për gjyqtarë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme;
- Konkurs i brendshëm për kryetar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Prishtinë – dega Gllogoc;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Prishtinë – dega Podujevë;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Ferizaj – dega Kaçanik;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore Prizren;
- Konkursi për gjyqtar të Gjykatave Themelore;
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Mitrovicë – dega Zubin Potok;

- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrësi të Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega Leposaviq;
- Konkurs i brendshëm për gjyqtarë Gjykata e Apelit – Divizioni i Mitrovicës dhe
- Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore Gjilan – dega Novobërdë.

12. SFIDAT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si organ kushtetues për administrimin e gjyqësorit gjatë vitit 2021 është përballur me këto sfida:

- Mos plotësimi i përbërjes së Këshillit, nga anëtarët që vijnë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Kryerja e punëve me staf të reduktuar, në periudha të caktuara, duke i zbatuar rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë e cila ka rezultuar në reduktimin e aktiviteteve nëpër gjykata dhe KGJK;
- Mungesa e buxhetit për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë sipas kërkesave që dalin nga Ligji për Gjykatat, (një gjyqtar një bashkëpunëtor profesional), si dhe stafit tjetër mbështetës për funksionimin e punës së sistemit gjyqësor në përgjithësi;
- Mos alokimi i buxhetit për praktikantë gjyqësor;
- Mungesa e mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, me fokus te veçantë lidhur me zbatimin e Vendimit të Qeverisë, Nr.04/20 i datës 20.12.2017;
- Shkurtimi i buxhetit nga Qeveria e Kosovës, lidhur me njëqind e gjashtëdhjetë e tetë (168) pozita të parapara për sistemin gjyqësor;
- Mungesa e hapësirave fizike në disa nga gjykatat e vendit, sa i përket mbajtjes së seancave gjyqësore;
- Zvarritja e procedurave të shpronësimit lidhur me parcelat përkatëse sa i përket tre (3) lokacioneve për ndërtimin e objekteve të gjykatave, në Prizren, Pejë dhe renovimin e objektit të Jugobankës në Mitrovicë;
- Menaxhimi jo i duhur i objektit të Pallatit të Drejtësisë nga Institucioni përkatës që merret me menaxhimin e objekteve publike;
- Mbikëqyrja e sigurisë së objektit të Pallatit të Drejtësisë;
- Asgjësimi i regjistrave dhe lëndëve gjyqësore;

- Përmirësimi i gjendjes së arkivave gjyqësore;
- Pengesat në dorëzimin e shkresave të gjykatave;
- Shpërndarja proporcionale e lëndëve të vjetra tek gjyqtarët;
- Evidentimi dhe inventarizimi i pasurisë;
- Furnizimi me material për mbrojtje nga virusi COVID-19 si dhe
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit gjyqësor.

www.gjyqesori-rks.org

Këshilli Gjyqësor i Kosovës